

4You magazine

www.magazineforyou.com



4You Magazine - Shqip

magazine4ushqip

radio
K4
• 90.2 • 96.6 •
www.radiokfor.com

Revistë mujore e KFOR-it Nr. 226 - Prill 2026



MUSICBOX

THE GUITAR
SISTERS & JONI

Falas

"4You Magazine" është publikim zyrtar i KFOR-it, prodhuar dhe financiar nga KFOR-i, i shtypur në Kosovë dhe shpërndahet pa pagesë. Përmbajtja nuk reflekton qëndrimin zyrtar të koalicionit apo të shteteve anëtare. KFOR-i pranon edhe i mirëpret opinionet tuaja dhe i publikon ato, por në formë të përmbledhur. Nëse kërkohet të mos tregohet emri i autorit, kjo mund të bëhet, por nuk do të publikohen letra anonime, shpifëse apo me qëllim të keq.

Kryeredaktore:

Leonora Shabanaj Nikshiq

Gazetarë: Ali Rexha,

Violeta Matovic,

Jelena Simic Rasic

Fotografite: Ekipi "4You"

Design & Layout:

Bekim Shabani &

Leopard Cana

Stafi editorial mund të kontaktohet në telefon:

038/503-603-2139

Letrat mund të dërgohen në adresën:

**HQ KFOR - Kosova Film;
"4You Magazine";**

**Strasbourg Building;
10000 Prishtinë**

E-mail:

magazineforyou2003@gmail.com

www.magazineforyou.com



**Kopertina: THE GUITAR
SISTERS & JONI**

Editorial

Lexues të dashur,

Muaji prill mbërrin si një premtim i qetë. Pas ditëve të gjata e me re, bota fillon të lulëzojë përsëri ngadalë. Pemët vishen me ngjyrë të gjelbër të zbehtë, lulet çelin pa frikë dhe ajri ndihet më i lehtë. Pranvera nuk nxiton. Ajo shpaloset butësisht dhe ndoshta ky është mësimi i saj më i madh për ne. Ashtu si natyra, ne na mundësohet që të rritemi me ritmin tonë. Pranvera na kujton se ndryshimi nuk duhet të jetë i zhurmshëm për të qenë i fuqishëm. Ndonjëherë, fillon me diçka të thjeshtë, si një buzëqeshje.

Fuqia e një buzëqeshjeje

Një buzëqeshje mund të duket e vogël, por mbart forcë të jashtëzakonshme. Mund t'ia ndriçojë ditën dikujt, të zbusë një moment të vështirë ose të japë kurajë kur fjalët janë të vështira për t'u gjetur. Buzëqeshja nuk do të thotë se gjithçka është perfekte. Do të thotë që ne e zgjedhim shpresën, edhe kur gjërat nuk janë perfekte. Mendoni për këtë: lulet çelin edhe pasi i mbijetojnë stuhisë. Ato nuk pretendojnë sikur dimri nuk ka ndodhur. Ato thjesht rriten gjithsesi. Buzëqeshja juaj është e njëjtë. Ajo i thotë botës: "Unë jam ende këtu. Unë jam ende duke u rritur".

Të lulëzosh në atë që je

Pranvera nuk ka të bëjë me atë që duhet të shndërrohet në një person të ri. Bëhet fjalë për t'u bërë diçka më shumë se ajo që tashmë

je. Në një botë plot me filtra, krahasime dhe pritje, mund të jetë e vështirë të pranosh veten plotësisht, pikat e forta dhe të dobëta, talentet dhe pasiguritë tua. Por, rritja e vërtetë fillon me vetëpranimin. Ashtu siç nuk ka dy lule identike, nuk ka dy njerëz të njëjtë. Disa çelin herët, disa çelin vonë, disa dallohen më shumë dhe ndriçojnë, të tjerat rriten qetësisht në hije. Megjithatë, secila është e bukur në mënyrën e vetë. Të pranosh veten nuk do të thotë të injorosh të metat e tua, do të thotë të kuptosh se ato janë pjesë e historisë tënde. Qarjet, mësimet, gabimet, ato të formësojnë. Ato të mësojnë qëndrueshmërinë (aftësinë për t'u përshtatur dhe rimëkëmbur). Ato të bëjnë njeri.

Një fillim i ri, nga brendia

Muaji prill na fton të rifillojmë, jo duke ndryshuar atë që jemi, por duke e përqafuar atë. Buzëqesh më shumë. Flisni me mirësi me veten. Lejojani vetes që të zhvilloheni pa presion. Këtë muaj, le të jetë buzëqeshja juaj dielli juaj. Le të shndërrohet pranimi juaj në rrënjët tuaja. Gjithashtu lërinë ëndrrat tuaja të lulëzojnë, me hapa të vegjël me radhë. Sepse pranvera nuk është vetëm një stinë përreth nesh, është një stinë brenda nesh.

**Miq të mi, deri në takimin tonë të radhës
në muajin maj, qëndroni të shëndetshëm!**

Leonora

Indeksi



2. Editoriali, indeksi

4. Shkolla e muajit: SHFMU "VESEL MUJA", KU BASHKËPUNIMI NDËRTON EKSELENCË

6. SHËNDETI MENDOR – NJË SHQETËSIM I PËRBASHKËT PËR TË RINJTË

8. Music Box: THE GUITAR SISTERS & JONI: NGA DHOMA E NDENJËS NË SKENË

12. ETNO PANAIRI NË GRAÇANICË: DUAR

QË KRIJOJNË, ZEMRA QË LIDHIN

14. World around us: VENDET KU TOKA "MERR FRYMË" - PLANETI QË KURRË NUK RRI NË GJENDJE TË QETË

16. Do it Yourself: SI TË PËRGATISNI NJË "KAFE TË DERDHUR" SI SHAKA E 1 PRILLIT?

18. Moviemania: PESË FILMA QË E BËJNË PRILLIN MË TË NDRITSHËM, MË TË GUXIMSHËM DHE PLOT AVENTURË

20. Health & Sports: KUPA E BOTËS E FIFA 2026 VENDOS NJË STANDARD TË RI GLOBAL

22. Generation #: 'MUST-HAVE' DIGJITAL: ABONIMET QË TA LEHTËSOJNË JETËN

24. ZGJEDHJE TË QETA, JETË MË TË SIGURTA
26. Your opinion about: MENDIMI JUAJ PËR APLIKACIONET QË I PËRDORNI MË SË SHPESHTI?

28. Wellbeing & teens: MIQ APO RIVALË? SI NDIKON XHELOZIA NË SHOQËRI?

30. SI T'I KAPËSH SHPEJT GABIMET E IA-SË

32. Did you know? LUMTURIA

Dear readers,

April arrives like a quiet promise. After long, grey days, the world slowly begins to bloom again. Trees dress themselves in soft green, flowers open without fear, and the air feels lighter. Spring does not rush. It unfolds gently, and maybe that is its greatest lesson for us. Just like nature, we are allowed to grow at our own pace. Spring reminds us that change does not have to be loud to be powerful. Sometimes, it begins with something simple, like a smile.

The power of a smile

A smile may seem small, but it carries incredible strength. It can brighten someone's day, soften a difficult moment, or give courage when words are hard to find. Smiling does not mean that everything is perfect. It means we choose hope, even when things are not. Think about it: flowers bloom even after surviving storms. They do not pretend the winter did not happen. They simply grow anyway. Your smile is the same. It tells the world: I am still here. I am still growing.

Blooming into who you are

Spring is not about becoming someone new. It is about becoming more of who you already are. In a world full of filters, comparisons, and expectations, it can

feel difficult to accept ourselves fully, our strengths and our weaknesses, our talents and our insecurities. But real growth begins with self-acceptance. Just as no two flowers are identical, no two people are the same. Some bloom early. Some bloom late. Some stand tall and bright; others grow quietly in the shade. Yet each one is beautiful in its own way. Accepting yourself does not mean ignoring your flaws. It means understanding that they are part of your story. The cracks, the lessons, the mistakes, they shape you. They teach you resilience (the ability to adapt and renew). They make you human.

A fresh start, from the inside out

April invites us to reset, not by changing who we are, but by embracing it. Smile more. Speak kindly to yourself. Allow yourself to grow without pressure. This month, let your smile be your sunshine. Let your acceptance be your roots. And let your dreams bloom, one small step at a time. Because spring is not only a season around us. It is a season within us.

Until our next meeting in May, stay healthy my friends!

Leonora

Index



3. Editorial, index

5. School of the month: EJHS "VESEL MUJA" WHERE COOPERATION BUILDS EXCELLENCE

7. MENTAL HEALTH - A SHARED CONCERN FOR YOUNG PEOPLE

9. Music Box: THE GUITAR SISTERS & JONI: FROM LIVING ROOM TO THE STAGE

13. ETNO FAIR IN GRACANICA: HANDS THAT CREATE, HEARTS THAT CONNECT

15. World around us: WHERE THE EARTH "BREATHES" - A PLANET THAT NEVER RESTS

17. Do it Yourself: HOW TO MAKE A "SPILLED COFFEE" APRIL FOOLS' PRANK

19. Movievania: FIVE FILMS THAT MAKE APRIL BRIGHTER, BOLDER, AND FULL OF ADVENTURE

21. Health & Sports: 2026 FIFA WORLD CUP SETS A NEW GLOBAL STANDARD

23. Generation #: DIGITAL 'MUST-HAVE': SUBSCRIPTIONS WHICH MAKE YOUR LIFE EASIER

25. CALM CHOICES, SAFER LIVES

27. Your opinion about: YOUR OPINION ON YOUR MOST USED APPS

29. Wellbeing & teens: FRIENDS OR RIVALS? HOW DOES JEALOUSY AFFECT FRIENDSHIP?

31. CROSSWORD PUZZLES

"4You Magazine" is an official publication of KFOR, produced and financed by KFOR, printed in Kosovo and distributed freely. The contents do not necessarily reflect the official point of view of the coalition or that of any of its member states. KFOR accepts and welcomes your opinions, it will publish some of these, eventually in a condensed form. If requested the name of the writer will be withheld but no anonymous, defamatory or malicious letters will be printed.

Chief Editor:

Leonora Shabanaj Nikshiq

Journalists:

Ali Rexha,
Violeta Matovic,
Jelena Simic Rasic

Photos by: "4You" Team

Design & Layout:

Bekim Shabani &
Leopard Cana

The editorial staff can be contacted on:

038/503-603-2139

Any letters can be sent at:

**HQ KFOR - Film City;
"4You Magazine";**

**Strasbourg Building;
10000 Pristina**

E-mail:

**magazineforyou2003@gmail.com
www.magazineforyou.com**



**Cover: THE GUITAR
SISTERS & JONI**

SHFMU “VESEL MUJA” KU BASHKËPUNIMI NDËRTON PËRSOSMËRI

Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët (SHFMU) “Vesel Muja” në fshatin Bresalc, Komuna e Gjilanit, dëshmon se suksesi nuk matet me madhësinë. Me 175 nxënës dhe hapësirë të kufizuar, shkolla vazhdon të renditet ndër më të mirat në komunë. Arritjet e saj mbështeten në udhëheqje të fortë, bashkëpunim të ngushtë me prindërit dhe përkushtimin e mësimitdhënësve.



z. Ajvaz Beqiri - drejtor

Një shkollë e lindur nga nevoja e komunitetit

Drejtori Ajvaz Beqiri, i cili është profesor i sociologjisë, e drejton shkollën që nga pavarësimi i saj në vitin 2010. Më parë ai kishte punuar si mësimitdhënës i Edukatës Qytetare në SHFMU “Ibrahim Uruqi” në Bresalc, kur “Vesel Muja” funksiononte si paralele e saj e ndarë. Distanca e mëdha ndërmjet lagjeve dhe rreziku i lartë nga trafiku pranë SHFMU “Ibrahim Uruqi” në rrugën Prishtinë – Gjilan i shtynë prindërit dhe këshillin e fshatit të kërkonin një shkollë të veçantë dhe më të sigurt. Me mbështetjen e tyre, kërkesa u miratua dhe në vitin 2010 shkolla nisi punën si institucion i plotë fillor dhe i mesëm i ulët.

Mësim në hapësirë të kufizuar

Objekti aktual u ndërtua në vitet 2002–2003, ndërsa mësimi filloi aty në vitin 2004. Në atë kohë ishin të regjistruar rreth 270 nxënës. Sot numri është 175, duke përfshirë nxënës nga Mihiri, Gllava, Poneshi dhe lagje të tjera përreth. Numri mbetet relativisht i

qëndrueshëm edhe falë zhvendosjes së familjeve nga zonat malore të Gjilanit drejt Bresalcit. Për shkak të mungesës së hapësirës mësimi zhvillohet në dy ndërrime. Klasat 6–9 vijnë në mësimin nga ora 8:00 deri në 12:50, ndërsa klasat 1–5 nga ora 13:00 deri në 17:20. Njëkohësisht funksionon edhe paralela e ndarë në fshatin Ponesh, ku 33 nxënës e ndjekin nivelin klasor dhe parashkollor.

Dobësia kryesore e shkollës mbetet mungesa e hapësirës, sidomos e kabineteve për lëndët praktike, ku nevoja për kabinet teknologjie është më urgjentja. Megjithatë, disa investime i kanë përmirësuar ndjeshëm kushtet. Ngrohja qendrore e ka rritur komoditetin gjatë dimrit. Komuna e Gjilanit e ka financuar një terren të hapur sportiv në vlerë prej 50 mijë eurosh, duke e mundësuar zhvillim më cilësor të edukatës fizike. Kurse, instalimi i kamerave e ka përmirësuar

disiplinën dhe performancën e përgjithshme të shkollës.

Rezultate që i tejkalojnë pritshmëritë

SHFMU “Vesel Muja” renditet vazhdimisht ndër dhjetë shkollat më të mira në komunë, një arritje domethënëse për një shkollë të vogël rurale. Në vitin 2025, pesë nxënës u renditën ndër dhjetë më të mirët në garat e matematikës të organizuara nga Shoqata e Matematikanëve të Gjilanit, ndërsa tre prej tyre e fituan vendin e tretë. Në garat kombëtare të robotikës, shkolla e arriti vendin e tetë vitin e kaluar. Kur këto rezultate shihen në raport me madhësinë dhe kushtet e shkollës, ato dëshmojnë përkushtim dhe punë të jashtëzakonshme.

Gjatë pandemisë, shkolla u përfshi edhe në një kurs të gjuhës shqipe dhe serbe, të mbështetur nga OSBE, në bashkëpunim me





shkollën serbe në Ponesh. Në një zonë me komunitete të përziera, njohja e gjuhës së njëri-tjetrit është thelbësore për komunikim dhe mirëkuptim të përditshëm.

Mësimdhënës që udhëheqin me shembull

Shkolla i ka 25 mësimdhënës, të mbështetur nga stafi administrativ dhe psikologu. Rreth 90 për qind e tyre janë profesionistë të rinj, shumë prej të cilëve me studime master, dhe ata marrin pjesë rregullisht në trajnime profesionale. Kjo lidhet ngushtë me besimin e drejtorit Beqiri në udhëheqje demokratike, ku theksi vihet te bashkëpunimi dhe jo te autoriteti i rreptë. Sipas tij, pika më e fortë e shkollës është bashkëpunimi i shëndoshë ndërmjet mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve. Ky bashkëpunim është rezultat i komunikimit të hapur dhe praktikave demokratike. Anketat e brendshme tregojnë kënaqësi të lartë të prindërve dhe përfshirje aktive në jetën shkollë. Ky trekëndësh pedagogjik krijon një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ku nxënësit inkurajohen të shprehën dhe të synojnë rezultate më të mira.

Objektiva të qarta për të ardhmen

Prioritet mbetet zgjerimi i hapësirave mësimore. Në plan është krijimi i një klase të hapur për zhvillimin e orëve gjatë muajve të ngrohtë dhe funksionalizimi i kabinetit të teknologjisë. Këto synojnë të ofrojnë kushte më moderne dhe më funksionale për punë praktike.

Në fund drejtori Beqiri përcolli një mesazh të qartë për nxënësit në mbarë Kosovën: "Duajeni veten, investoni në arsim, besoni në aftësitë tuaja dhe largohuni nga ndikimet negative."

EJHS "VESEL MUJA" WHERE COOPERATION BUILDS EXCELLENCE

Elementary and Junior High School (EJHS) "Vesel Muja" in the village of Bresalc, Municipality of Gjilan, proves that success is not defined by size. With 175 students and limited space, the school continues to rank among the top schools in the municipality. Its achievements are built on strong leadership, close cooperation with parents, and the dedication of its teaching staff.

A school born from community need

Director Ajvaz Beqiri, a sociology teacher by profession, has led the school since it became independent in 2010. Before that, he worked as a Civic Education teacher at EJHS "Ibrahim Uruqi" in Bresalc, when "Vesel Muja" functioned as a separated unit. Long distances between neighborhoods and the high traffic risk near EJHS "Ibrahim Uruqi" on the Prishtina-Gjilan road pushed parents and the village council to request a separate, safer school. With their support, the request for independence was accepted, and in 2010 the school began operating as a full Elementary and Junior High School.

Learning in limited space

The current building was constructed between 2002 and 2003, and classes began there in 2004. At that time, around 270 students were enrolled. Today, the number stands at 175, including students from Mihiri, Gllava, Ponesh, and other nearby neighborhoods, and it remains stable partly due to families moving from mountainous parts of Gjilan to Bresalc. The school operates in two shifts because the building does not provide enough classrooms. Grades 6 to 9 attend from 8:00 to 12:50, while grades 1 to 5 begin at 13:00 and finish at 17:20. There is also a separated unit in Ponesh village, where 33 students attend lower grade and preschool classes.

The school's biggest weakness remains space, especially the lack of laboratories for practical subjects, with technology being the most urgent need. Despite these limitations, several improvements have strengthened learning conditions. Central heating has increased comfort during winter months. The Municipality of Gjilan financed an outdoor sports field worth 50,000 euros, allowing students to carry out physical education more effectively. Whereas, security cameras have also improved discipline and positively influenced school performance.

Results that exceed expectations

EJHS "Vesel Muja" consistently ranks among the top ten schools in the municipality, which is a remarkable achievement for a small rural school. In 2025, five of its students ranked among the top ten in mathematics competitions organized by the Association of Mathematicians of Gjilan, and three of them achieved third place. In national robotics

competitions, the school achieved eighth place last year. When these accomplishments are viewed in relation to the school's size and infrastructure, they highlight extraordinary commitment and effort.

During the pandemic, the school also joined an OSCE supported Albanian and Serbian language course in cooperation with the Serbian school in Ponesh. In an area where mixed communities live close to one another, learning each other's language is not only educational but essential for everyday communication and mutual understanding.

Teachers who lead by example

The school employs 25 teachers, supported by administrative staff and a psychologist. Around 90 percent of the teachers are young professionals, many holding master's degrees and actively participating in professional trainings. This is combined with the fact that Director Beqiri strongly believes in democratic leadership, as he focuses on cooperation rather than strict authority. According to Director Beqiri, the school's strongest point is the healthy collaboration between teachers, parents, and students. This spirit of cooperation is not accidental but the result of consistent democratic leadership and open communication. Internal surveys show that parents express high satisfaction and remain actively involved in school life. This strong pedagogical triangle creates a supportive and safe environment where students feel encouraged to express themselves and strive for better results.

Clear goals for the future

One of the school's main priorities is expanding learning space. Plans include creating an open classroom for outdoor lessons during warmer months and establishing a technology laboratory. These improvements aim to provide students with modern learning opportunities and better conditions for practical work.

Director Beqiri shared a clear message for students across Kosovo: "Love yourselves, invest in education, believe in your abilities, and stay away from negative influences."

SHËNDETI MENDOR - NJË SHQETËSIM I PËRBASHKËT PËR TË RINJTË

TË RINJTË TAKOHEN PËR TË DISKUTUAR MIRËQENIEN MENDORE

Rishtas, rreth njëzet të rinj nga Mitrovica e Veriut dhe e Jugut u mbledhën në Kodrën e Minatorëve në Mitrovicën e Veriut për të marrë pjesë në një aktivitet rinor të fokusuar në shëndetin mendor dhe mirëqenien. Ngjarja u organizua nga Community Building Mitrovica (CBM) si pjesë e projektit "Nxitja e Bashkëpunimit Ndër-etnik dhe Angazhimit Qytetar të të Rinjve", i cili i inkurajon të rinjtë që t'i diskutojnë sfidat e përbashkëta dhe të punojnë së bashku për zgjidhje. Ulur mbi dyshekë për joga dhe duke punuar në çifte, pjesëmarrësit ushtruan teknika frymëmarrjeje që mund t'i ndihmojnë të përballen me stresin dhe ankthin. Aktiviteti synonte të promovonte mirëqenien mendore duke krijuar një hapësirë ku të rinjtë mund të takohen, të komunikojnë dhe të mësojnë nga njëri-tjetri.

Identifikimi i sfidave së bashku

Marina Jakovljeviq, koordinatore e projektit "Nxitja e Bashkëpunimit Ndër-etnik dhe Angazhimit Qytetar të të Rinjve", i zbatuar nga Community Building Mitrovica (CBM), shpjegoi se aktiviteti është pjesë e një procesi më të gjerë në të cilin të rinjtë identifikojnë sfidat në jetën e tyre dhe punojnë së bashku për t'i adresuar ato. "Të rinjtë morën pjesë



në një aktivitet të fokusuar në promovimin e shëndetit mendor. Ata ushtruan teknika frymëmarrjeje si një metodë parandaluese që mund t'i ndihmojë t'i rregullojnë emocionet kur ndihen të shqetësuar ose nën stres," tha Jakovljeviq. "Kjo është vetëm një nga shumë aktivitetet që po organizojmë bazuar në çështjet që të rinjtë nga të gjitha etnitë i kanë identifikuar. Mes tyre, shëndeti mendor është theksuar si një nga më të rëndësishmit." Ajo shtoi se hapi i radhës do të përfshijë diskutime me vendimmarrësit për të eksploruar mënyrat se si të shfrytëzohen burimet

ekzistuese për të mbështetur dhe përmirësuar shëndetin mendor tek të rinjtë. "Porosia për të rinjtë është të punojnë me veten, të ndikojnë në rrethin e tyre dhe të krijojnë shoqërinë në të cilën duan të jetojnë," përfundoi Jakovljeviq.

Ndërtimi i urave të mirëkuptimit

Kastriot Krasniqi, anëtar i Community Building Mitrovica, tha se aktivitete të tilla krijojnë hapësirë që të rinjtë nga etni të ndryshme të takohen, të komunikojnë dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. "Aktiviteti ynë synon të bashkojë të rinj me prejardhje të ndryshme për të ndërtuar ura mirëkuptimi dhe për të promovuar shëndetin mendor si një vlerë të përbashkët," tha Krasniqi. "Përmes dialogut të hapur dhe respektit të ndërsjellë, ne krijojmë hapësira të sigurta ku çdo zë mund të dëgjohet dhe vlerësohet".

Blerona Sylaj, asistente e projektit në National Endowment for Democracy (Fondi Kombëtar për Demokraci - NED), tha se aktiviteti ishte përqendruar në përmirësimin e mirëqenies mendore, duke inkurajuar njëkohësisht komunikimin mes

të rinjve nga etni të ndryshme. "Ky aktivitet krijon mundësi që të rinjtë të kuptojnë më mirë kulturat dhe perspektivat e njëri-tjetrit", tha Sylaj. "Përmes aktiviteteve të përbashkëta dhe dialogut konstruktiv, ne i forcojmë lidhjet mes të rinjve dhe promovojmë një kulturë paqeje, respekti dhe mirëqenieje".

Mësimi i teknikave për të menaxhuar stresin

Seanca praktike u udhëhoq nga instruktoria e jogës, Damira Bahadır, e cila i ka katërmëdhjetë vjet përvojë. Ajo punoi me pjesëmarrësit mbi teknikat e frymëmarrjes dhe shpjegoi se si ato mund të përdoren në situata të përditshme stresuese. "Teknikat e frymëmarrjes mund të ndihmojnë ndjeshëm në rregullimin e stresit dhe situatave stresuese në jetën e përditshme", tha Bahadır. "Porosia ime për të rinjtë është e thjeshtë: merrni frymë thellë dhe gjërat do të bëhen më të lehta".

Zërat e të rinjve ndajnë një përvojë të përbashkët

Pjesëmarrësit i ndanë edhe përshtypjet e tyre për aktivitetin. Adea Tahiri (20),



nga Mitrovica e Jugut, tha se takimi u fokusua në mësimin e teknikave të frymëmarrjes dhe diskutimin së bashku për shëndetin mendor. “Të rinjtë serbë dhe shqiptarë janë këtu bashkë duke mësuar teknika frymëmarrjeje. Këto aktivitete na ndihmojnë të ndërtojmë miqësi dhe të lidhemi me njëri-tjetrin”, tha Tahiri. “E njohim të kaluarën dhe ndikimin e saj, por me kalimin e kohës rrethanat kanë ndryshuar. Sot ndihemi rehat duke komunikuar me njëri-tjetrin, duke kaluar kohë së bashku dhe duke marrë pjesë në aktivitete së bashku”.

Nikolina Jovanović (19), nga Mitrovica e Veriut, tha se ngjarja mbledhi së bashku të rinj nga prejardhje të ndryshme për të hapur një dialog mbi shëndetin mendor. “Qëllimi është të tregojmë se sfidat me të cilat përballen të rinjtë janë universale”, tha Jovanović. “Përmes bisedës dhe bashkëpunimit, duam të ndërtojmë besim, mirëkuptim dhe mbështetje të ndërsjellë”.



Aktiviteti e pasoi një diskutim të mëhershëm në tryezë të rrumbullakët me psikologë, i cili mbledhi së bashku të rinj nga të dyja pjesët e Mitrovicës për të diskutuar hapur sfidat e shëndetit mendor. Diskutimi ndihmoi në mbledhjen e ideve për një fushatë avokuese të udhëhequr nga të rinjtë, pasi pjesëmarrësit e identifikuan shëndetin mendor si një nga çështjet kryesore që ndikon në mirëqenien e tyre.

Na vizitoni në:
Visit us at:



MENTAL HEALTH - A SHARED CONCERN FOR YOUNG PEOPLE - YOUNG PEOPLE MEET TO DISCUSS MENTAL WELLBEING

Recently, around twenty young people from North and South Mitrovica gathered on Miners' Hill in North Mitrovica to take part in a youth activity focused on mental health and wellbeing. The event was organized by Community Building Mitrovica (CBM) as part of the project “Fostering Interethnic Cooperation and Youth Civic Engagement”, which encourages young people to discuss common challenges and work together on solutions. Sitting on yoga mats and working in pairs, the participants practiced breathing techniques that can help them deal with stress and anxiety. The activity aimed to promote mental wellbeing while creating a space for young people to meet, communicate, and learn from each other.

Identifying challenges together

Marina Jakovljevic, coordinator of the project “Fostering Interethnic Cooperation and Youth Civic Engagement”, implemented by Community Building Mitrovica (CBM), explained that the activity is part of a wider process in which young people identify challenges in their lives and work together to address them. “Young people took part in an activity focused on promoting mental health. They practiced breathing techniques as a preventive method that can help them regulate their emotions when they feel anxious or under stress,” Jakovljevic said. “This is only one of many activities we are organizing based on the issues that young people from all ethnicities have identified. Among them, mental health was highlighted as one of the most important.” She added that the next step will involve discussions with decision makers to explore ways to use existing resources to support and improve mental health among young people. “The message for young people is to work on themselves, influence their surroundings, and create the society they want to live in,” Jakovljevic concluded.

Building bridges of understanding

Kastriot Krasniqi, a member of Community Building Mitrovica, said that activities like this create space for young people from different ethnicities to meet, communicate, and learn from each other. “Our activity aims to bring together young people from various backgrounds to build bridges of understanding and promote mental health as a shared value,” Krasniqi said. “Through open dialogue and mutual respect, we create safe spaces where every voice can be heard and valued.”

Blerona Sylaj, project assistant for the National Endowment for Democracy (NED), said the activity focused on improving mental wellbeing while also encouraging communication between young people from different ethnicities. “This activity creates opportunities for young people to better understand each other’s cultures and perspectives,” Sylaj said. “Through shared activities and constructive dialogue, we strengthen connections among young people and promote a culture of peace, respect, and wellbeing.”

Learning techniques to manage stress

The practical session was led by yoga instructor Damira Bahadir, who has fourteen years of experience. She worked with the participants on breathing techniques and explained how they can be used in everyday stressful situations. “Breathing techniques can significantly help regulate stress and stressful situations in daily life,” Bahadir said. “My message to young people is simple: breathe deeply and things will become easier.”

Young voices share a common experience

Participants also shared their impressions of the event. Adea Tahiri (20), from South Mitrovica, said the meeting focused on learning breathing techniques and discussing mental health together. “Young Serbs and Albanians are here together learning about breathing techniques. These activities help us build friendships and connect with each other,” Tahiri said. “We know the past and its impact, but over time circumstances have changed. Today we feel comfortable communicating with one another, spending time together, and taking part in activities together.” Nikolina Jovanovic (19), from North Mitrovica, said the event brought together young people from different backgrounds to open a dialogue on mental health. “The goal is to show that the challenges young people face is universal,” Jovanovic said. “Through conversation and cooperation, we want to build trust, understanding, and mutual support.”

The activity followed an earlier roundtable discussion with psychologists that brought together young people from both parts of Mitrovica to openly discuss mental health challenges. The discussion helped gather ideas for a youth-led advocacy campaign, after participants identified mental health as one of the key issues affecting their wellbeing.



NGA DHOMA E NDENJËS NË SKENË



MUSICBOX

Disa histori muzikore fillojnë në studio. Të tjera fillojnë në skena të mëdha nën drita të forta. Për The Guitar Sisters & Jon, gjithçka filloi në shtëpi, në mbremje që në atë kohë dukeshin të zakonshme, por më vonë u bënë kujtime të paharrueshme. Shumë kohë para

koncerteve, festivaleve dhe paraqitjeve publike, ishte thjesht një shtëpi e mbushur me tinguj. Instrumentet nuk ishin kurrë zbukurim, por pjesë e jetës së përditshme. Një melodi mund të niste në çdo moment, pas darke, gjatë bisedave apo kur vinin mysafirë. Këngët nuk praktikoheshin për duartrokitje, por ndaheshin natyrshëm fillimisht brenda familjes. Sot, vëllezërit e motrat performojnë para publikut të të gjitha moshave, megjithatë muzika e tyre e mban ende të njëjtën ndjenjë që e kishte në dhomën e ndenjes ku gjithçka filloi, të afërt, të singertë dhe të ngrohtë.



Rrënjët e tingullit

Frymëzimi i tyre i parë nuk erdhi nga trendet apo rrjetet sociale, por nga babai i tyre. Ai kishte pasion të madh për muzikën dhe madje e punonte vetë instrumentin tradicional të çiftelisë. Fëmijët shikonin, dëgjonin dhe ngadalë u bënë pjesë e tingullit përreth tyre. Në fillim ishte kureshtje. Pastaj u bë zakon. Në fund, dashuri. "Muzika hyri në jetën tonë si diçka normale, jo si diçka që e planifikuam si profesion," shpjegon Rrezarta. "Ne thjesht kënaqeshim duke kënduar bashkë çdo ditë."

Krenarja tregoi interes shumë herët. Gjatë një dasme familjare, kur ishte vetëm katër vjeçe, një këngëtar e vuri re duke kënduar dhe i ofroi mikrofonin. Pa hezitim, ajo këndoi me vetëbesim para të gjithëve. Moment që i habiti të pranishmit, por për familjen ishte krejtësisht i natyrshëm. Së shpejti fëmijët filluan të përsërisnin këngë në shtëpi, jo sepse iu kërkohej, por sepse dëshironin vetë. Muzika u bë një gjuhë e përbashkët në familje, një mënyrë për të kaluar kohë bashkë dhe për ta kuptuar njëri-tjetrin pa shumë fjalë.

Të mësuarit e mjeshtërisë

Pika e vërtetë e kthesës erdhi kur Krenarja u regjistrua në një kurs kitare në Podujevë. Ajo nuk i kishte mbushur ende shtatë vjet. Rrezarta e shoqëronte me autobus nga Lupçi i Epërm në qytet. Pasi vuri re praninë e saj të rregullt, mësuesi Ymer Musa e ftoi edhe atë të bashkohej në mësim. Ajo ftesë e thjeshtë ndryshoi gjithçka. Praktika u bë rutinë. Rutina u bë disiplinë. Të dyja motrat vazhduan arsimin formal muzikor. Rrezarta më vonë përfundoi shkollën e mesme të muzikës 'Preng Jakova' në Prishtinë dhe studioi kompozim në universitet. Krenarja gjithashtu e përfundoi shkollën e muzikës dhe tani studion trombon





THE GUITAR SISTERS & JONI



FROM THE LIVING ROOM TO THE STAGE

Some musical stories begin in studios. Others begin on big stages under bright lights. For The Guitar Sisters & Jon, everything started at home, in evenings, that felt ordinary at the time but later became unforgettable memories. Long before concerts, festivals, and public performances, there was simply a house filled with soundS. Instruments were never a decoration, but part of daily life. A melody could begin at any moment, after dinner, during conversations, or while guests visited. Songs were not practiced for applause but shared naturally inside the family first. Today, the siblings perform in front of audiences of all ages, yet their music still carries the same feeling it had in the living room where it all began, close, sincere, and warm.

në Fakultetin e Arteve. Vëllai i tyre më i vogël, Jon, ndoqi të njëjtin drejtim dhe vijon shkollën e muzikës për fizarmonikë. "Të mësonim bashkë na mbante të motivuar," thotë Krenarja. "Nëse njëri përmirësohej, të tjerët donin të përmirësoheshin gjithashtu." Performancat ngadalë dolën jashtë shtëpisë. Filluan të marrin pjesë në festivale në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Udhëtimi për muzikë u bë pjesë e rritjes, rrugëtime të gjata, prova para koncerteve dhe emocion para daljes në skenë. Çdo udhëtim u mësoi diçka të re: durim, përgjegjësi dhe vetëbesim.

Të luash si një i vetëm

Të performosh me motrat dhe vëllanë e krijojnë një atmosferë të veçantë në skenë. Koordinimi bëhet natyrshëm sepse komunikimi nuk kërkon gjithmonë fjalë. Një shikim apo lëvizje e vogël mjafton për ta kuptuar hapin tjetër muzikor. Provat nuk janë gjithmonë perfekte. Ndonjëherë mendimet ndryshojnë për tempon, stilin apo aranzhimin. Megjithatë mosmarrëveshjet zgjasin pak sepse qëllimi mbetet i përbashkët. Secili anëtar e ka rolin e vet. Rrezarta udhëheq dhe bën solo në kitarë, Krenarja i mban akordet dhe Joni ritmin. Gjatë këndimit zërat ndërthuren me kujdes që harmonia të ndihet e balancuar dhe jo konkurruese. "Të jesh familje e bën skenën të ndihet e sigurt," thotë Joni. "Ndjehet më shumë si ndarje momenti sesa si detyrë." Një nga performancat më të paharrueshme ndodhi në sheshin e Prishtinës në një koncert të organizuar nga komuna. Madhësia e publikut ishte më e madhe se çdo përvojë e mëparshme. Megjithatë, pas këngës së parë

Roots of the sound

Their first inspiration did not come from trends or social media, but from their father. He had a deep passion for music and even crafted the traditional instrument çifteli himself. The children watched, listened, and slowly became part of the sound around them. At first it was curiosity. Then habit. Finally, love. "Music entered our lives as something normal, not something we planned as a profession," explains Rrezarta. "We just enjoyed singing together every day."

Krenarja showed interest especially early. During a family wedding, when she was only four years old, a singer noticed her singing along and offered her the microphone. Without hesitation, she sang confidently in front of everyone. The moment surprised the guests, but for the family it felt completely natural. Soon the children began repeating songs at home, not because they were asked to, but because they wanted to. Music became a shared language inside the family, a way to spend time together and understand each other without many words.

Learning the craft

The real turning point came when Krenarja enrolled in a guitar course in Podujevë. She was not even seven years old. Rrezarta accompanied her on the bus from Lupç i Epërm to the city. After noticing her regular presence, teacher Ymer Musa invited her to join the lessons as well. That simple invitation changed everything. Practice

became routine. Routine became discipline. Both sisters continued formal musical education. Rrezarta later completed the music high school Prek Jakova in Prishtina and studied composition at university. Krenarja also finished music school and now studies trombone at the Faculty of Arts. Their younger brother Jon followed the same path and attends the music school for accordion.

"Learning together kept us motivated," says Krenarja. "If one of us improved, the others wanted to improve too." Performances slowly moved beyond home. They began appearing at festivals in Kosovo, Albania, Montenegro, and North Macedonia. Traveling together for music became part of growing up, long drives, rehearsals before concerts, and excitement before stepping on stage. Each trip taught them something new, patience, responsibility, and confidence.

Playing as one

Performing with siblings creates a special atmosphere on stage. Coordination becomes natural because communication does not always require words. A glance or small movement is often enough to understand the next musical step. Rehearsals are not always perfect. Sometimes opinions differ about tempo, style, or arrangement. Yet disagreements rarely last long because the goal remains shared. Each member has a clear role. Rrezarta leads and performs guitar solos, Krenarja handles



arrijnë sa më lart duke mbetur autentikë. Dëshirojnë edhe bashkëpunime me artistë që admirojnë, veçanërisht me legjendaren Vaçe Zela, këngët e së cilës i konsiderojnë thesare të përhershme. Mesazhi për të rinjtë është i thjeshtë: duajeni artin, respektoni traditën dhe krijoni bashkë. Muzika për ta nuk është vetëm argëtim, por identitet dhe kujtesë.

Kur një këngë bëhet kujtim

Ndër shumë këngët që i interpretojnë, njëra mbart peshë të veçantë emocionale, kënga kushtuar Ganimete Tërbeshtit. Lidhja është edhe personale pasi edhe nëna e tyre e mban të njëjtin emër, duke e bërë performancën edhe më të afërt. Kur e interpretojnë këtë këngë, atmosfera ndryshon. Publiku bëhet më i qetë dhe performanca ndihet më pak si koncert dhe më shumë si kujtesë e përbashkët. Ata i qasen këngës me kujdes duke e kuptuar se ajo përfaqëson histori po aq sa muzikë.

Ata shpjegojnë se interpretimi i këngëve të tilla sjell përgjegjësi. Qëllimi nuk është vetëm të këndohet saktë, por të ruhet ndjenja dhe respekti. Çdo notë duhet të mbajë kuptim, jo vetëm melodi. Për dëgjuesit e rinj shpesh është hyrja e parë në të kaluarën, ndërsa për më të moshuarit zgjon kujtime. Në ato momente zhduket distanca mes brezave. Muzika bëhet urë mes historive, emocioneve dhe kohës. Përmes performancave të tilla, The Guitar Sisters & Jon tregojnë se muzika mund të argëtojë, por edhe të kujtojë, nderojë dhe mësojë njëkohësisht.



ndjenja u rikthye, njësoj si të këndonin në shtëpi, vetëm më fort. Ata e kuptuan se skena nuk e ndryshon muzikën. Ajo vetëm e ndan me më shumë njerëz.

Më shumë se muzikë

Grupi performon zhanre të ndryshme: këngë të lehta, muzikë qytetare, serenata korçare dhe repertor folklorik shqiptar. Për ta, kjo larmi nuk është vetëm zgjedhje artistike, por përgjegjësi kulturore. Ata duan që të rinjtë të dëgjojnë këngë që i lidhin brezat dhe e ruajnë traditën. Disa këngë kanë domethënie të veçantë dhe kërkojnë jo vetëm teknikë por edhe respekt. Rrjetet sociale i kanë ndihmuar të lidhen me dëgjues të rinj. Gjatë pandemisë performancat online u bënë skena e tyre kryesore. Shumë ndjekës i zbuluan aty dhe më pas erdhën në koncerte. Tani publiku shpesh këndon bashkë me ta duke e kthyer performancën në përvojë të përbashkët.

Balancimi i shkollës, jetës private dhe muzikës mbetet sfida, sidomos në sezonet me shumë angazhime dhe udhëtime. Detyrat shpesh presin deri vonë pas performancave. Koha e lirë është e rrallë, por ata e pranojnë si pjesë të rrugëtimit. Ëndrra e tyre është të



Muzika shpesh fillon si shprehje personale por ndonjëherë rritet në diçka më të madhe. The Guitar Sisters & Jon nuk filluan me plan karriere. Ata filluan me mbrëmje të përbashkëta në shtëpi. Me kalimin e kohës ato u kthyen në performanca, udhëtime dhe publik. Historia e tyre tregon se muzika nuk fillon gjithmonë nga ambicia. Ndonjëherë fillon nga familja dhe mbetet familje edhe kur ndizen dritat e skenës.

FAKTE TË SHPEJTA PËR GRUPIN

- Bashkëpunimi i ëndrrave: Vaçe Zela
- Festivali historik i preferuar: Akordet e Kosovës
- Talenti i fshehur: Joni vallëzon
- Frymëzim muzikor: këngë për natyrën si Baresha
- Ushqimi i preferuar: ushqim tradicional nga Kosova
- Dëshira për të ardhmen: më shumë mbështetje për vlerat e vërteta artistike

Për lexuesit tanë të rregullt:
Mund ta mbani mend mësuën e muzikës Ymer Musa, të prezantuar më parë në revistën tonë. Inkurajimi i tij luajti rol të rëndësishëm kur ai e ftoi Rrezartën të bashkohej në klasën e kitarës.

chords, and Jon maintains rhythm. During singing, their voices blend carefully so harmony feels balanced rather than competitive.

“Being family makes the stage feel safe,” says Jon. “It feels more like sharing a moment than performing a task.” One of their most memorable performances took place in Prishtina’s main square during a concert organized by the municipality. The size of the audience was larger than anything they had experienced before. Still, after the first song, the feeling returned, just like singing at home, only louder. They realized the stage does not change the music. It only shares it with more people.

More than music

The group performs various genres, light songs, urban traditional music, serenades from Korça, and Albanian folk repertoire. For them, diversity is not only an artistic choice but a cultural responsibility. They want younger listeners to hear songs that connect generations and keep traditions alive. Some songs have especially deep meaning. Performing such music requires not only technique but respect. Social media has helped them connect with young listeners. During the pandemic, online performances became their main stage. Many followers discovered them digitally and later attended concerts in person. Now, audiences often sing along, turning performances into shared experiences.

Balancing school, private life, and music remains challenging, especially during busy seasons and long travel days. Homework sometimes waits for late evenings after performances. Free time becomes rare, but they accept this as part of their journey. Their dream is to reach the highest level possible while remaining authentic. They also hope to collaborate with artists they admire, especially the legendary Vaçe Zela, whose songs they consider timeless treasures. Their message to young people is simple, love art, respect tradition, and create together. Music, for them, is not only entertainment but identity and memory.

When a song becomes a memory

Among the many songs they perform, one carries a particularly deep emotional weight for the group, the song dedicated to Ganimete Tërbeshi. The connection is also personal, since their mother shares the same name,

making the performance feel even closer to home. When they play this piece, the atmosphere changes. The audience becomes quieter, and the performance feels less like a concert and more like a shared memory. The siblings approach the song carefully, understanding that it represents history as well as music.

They explain that performing such songs brings responsibility. The goal is not only to sing correctly, but to preserve feeling and respect. Each note must carry meaning, not only melody. For younger listeners, the song often becomes a first introduction to the past. For older listeners, it awakens memories. In those moments, the distance between generations disappears. Music becomes a bridge between stories, emotions, and time. Through performances like this, The Guitar Sisters & Jon show that music can entertain, but it can also remind, honor, and teach all at once.

Music often begins as personal expression but sometimes grows into something larger. The Guitar Sisters & Jon did not begin with a career plan. They began with shared evenings at home. Over time, those evenings turned into performances, travel, and audiences. Their story shows that music does not always start with ambition. Sometimes it starts with family and remains family, even when the stage lights turn on.

QUICK STRINGS — FAST NOTES ABOUT THE BAND

- Dream collaboration: Vaçe Zela
- Favorite historic festival: Akordet e Kosovës
- Hidden talent: Jon enjoys dancing
- Favorite musical inspiration: nature themed songs like Baresha
- Favorite food: traditional natural food from Kosovo
- Wish for the future: stronger support for real artistic values

For our regular readers:
You may remember music teacher Ymer Musa, previously featured in our magazine. His encouragement played an important role when he invited Rrezarta to join the guitar class.

ETNO PANAIRI NË GRAÇANICË

DUAR QË KRIJOJNË, ZEMRA QË LIDHIN

Në fillim të dhjetorit, Qendra Kulturore në Graçanicë mirëpriti Etno Panairin “Duart që Krijojnë, Zemrat që Lidhin”, organizuar nga Shoqata e Grave të Biznesit “Avenija”. Gra nga pjesë të ndryshme të Kosovës, serbe, shqiptare, boshnjake, rome dhe gorane të Kosovës – u mbledhën në një vend për të prezantuar punimet e tyre, traditat dhe idetë e tyre sipërmarrëse.

Panairi është pjesë e projektit “Të Kuptuarit e Pasurisë së Diversitetit”, të cilin Avenija po e zbaton me mbështetjen e UNMIK-ut. Atij i paraprinë gjashtë punëtori të dedikuara zhvillimit të sipërmarrjes së grave dhe forcimit të mirëkuptimit të ndërsjellë përmes punës praktike. Sesioni përmbyllës, i fokusuar në temën “Fuqia e Diversitetit në Sipërmarrje”, mbledhi 20 gra nga e gjithë Kosova, të cilat përmes aktiviteteve ndërvepruese shkëmbyen përvoja, diskutuan sfida dhe mësuuan se si diversiteti mund të shndërrohet në një përparësi.

Unitet përmes punës dhe traditës

Ramiza Shaipi nga Ljubinja e Epërme prezantoi traditën e endjes së rajonit të Prizrenit. “Kjo është tradita jonë. Gratë endin pjesë tradicionale të kostumit popullor, të cilat arrijnë vlerë shumë të lartë në treg. Është e rëndësishme që gratë të punojnë, të jenë të përkushtuara, të forta dhe, mbi të gjitha, të shëndetshme,” tha Ramiza, duke treguar punimet e endura me dorë që tërhoqën vëmendjen e vizitorëve.



Gordana Toskic nga Graçanica, anëtare e shoqatës së grave “Katering në Lugë”, tha se ideja e tyre lindi nga dëshira për të kombinuar atë që duan me diçka që mund të gjenerojë të ardhura. “Duam të punojmë, të fuqizohemi ekonomikisht dhe të tregojmë se gratë janë të afta për shumë. Atyre u duhet vetëm të fillojnë dhe të kenë një qëllim të qartë.” Ajo shtoi se çdo aktivitet i tillë është një ftesë për gra të tjera që të bëjnë ndryshim. “I ftojme të gjitha gratë që duan të punojnë, që duan të ndryshojnë diçka në jetën e tyre,” theksoi Toskic.

Përmes trashëgimisë së përbashkët ndërtojmë besim

Drejtoresha e organizatës “Hanuma”, Shukrije Gori Markovic, theksoi se mirëkuptimi i ndërsjellë mes njerëzve është thelbësor për stabilitetin dhe përparimin e Kosovës. Ajo vuri në dukje se e ardhmja ndërtohet mbi themelet e respektit të ndërsjellë, dialogut të hapur dhe ruajtjes së identitetit kulturor. “Këtu në Kosovë, forca jonë qëndron në pasurinë e kulturave, zakoneve dhe traditave që na bëjnë unikë. Kur e festojmë së bashku multietnicitetin, ne jo vetëm

që i pranojmë dallimet, por i shndërrojmë ato në ura që na lidhin. Duke festuar atë që na bashkon, ne dërgojmë një mesazh të qartë: përmes trashëgimisë së përbashkët ndërtojmë besim, respekt të ndërsjellë dhe themelet e një shoqërie ku secili ndihet i sigurt dhe i vlerësuar. Kështu krijojmë një të ardhme më të fortë, më stabile dhe më të drejtë për të gjithë njerëzit në Kosovë,” theksoi Shukrija.

Kur bashkëpunimi shndërrohet në miqësi Gordana Djoric, kryetare e Shoqatës së Grave të Biznesit “Avenija” nga Laplje Selo, u pajtua me këtë qasje. Ajo theksoi se punëtoritë nuk u fokusuan vetëm te produktet, por edhe te marrëdhëniet. “Gratë nga të gjitha pjesët e Kosovës janë këtu – serbe, shqiptare, rome, boshnjake dhe gorane të Kosovës po marrin pjesë. Ne kemi punuar së bashku, kemi mësuar, kemi shkëmbyer përvoja dhe jemi bërë mike. Besoj se do të vazhdojmë të punojmë së bashku edhe në të ardhmen dhe të arrijmë edhe më shumë. Gjithçka varet nga besimi i grave në vetvete dhe në idetë e tyre.” Sipas saj, secila pjesëmarrëse solli atë që kishte krijuar më herët, por tani në një formë të përmirësuar dhe me cilësi më të lartë, falë trajnimeve që morën në organizatë si dhe njohurive që tashmë kishin. Djoric tha se është krenare për diversitetin e produkteve të ekspozuara, duke theksuar se vizitorët mund të shihnin punime artizanale, pjesë të kostumeve tradicionale, veshje me motive etno, si dhe një përzgjedhje të pasur



ëmbëlsirash dhe ushqimesh të gatshme.

"Besoni në vetvete"

Sa i përket planeve të ardhshme, Djoric pret më shumë mbështetje për të gjitha gratë në Kosovë sepse, siç thotë ajo, ato janë shtylla e çdo shoqërie. "Shpresoj që të marrim më shumë mbështetje nga fondacionet dhe ambasadat që ndajnë fonde për këtë. Ne duam të punojmë së bashku, qoftë në treg apo përmes projekteve të reja, dhe të sigurojmë pajisje të caktuara që do t'u ndihmonin grave të përmirësojnë cilësinë e produkteve të tyre. Sigurisht, plani ynë është edhe të organizojmë më shumë panairë si ky, të cilat u japin mundësi këtyre produkteve të prezantohen." Djoric i inkurajoi gratë të besojnë në vetvete: "Gjithçka varet nga ju. Nëse hidhni një hap drejt ideve tuaja, jam e sigurt se ato do të realizohen. E rëndësishme është të besoni në veten tuaj dhe të filloni."



Larmia e stendave dhe bashkëpunimi i ndërsjellë
Ky panair nuk ishte vetëm një ekspozitë e punimeve artizanale, por edhe një kornizë e përbashkët bashkëpunimi e ndërtuar përmes punëtorive dhe takimeve. Ishte një hapësirë ku gratë mësuuan nga njëra-tjetra, zhvilluan aftësitë e tyre sipërmarrëse dhe krijuan lidhje që mund t'u hapin dyer të reja. Etno Panairi u mbajt gjithashtu në Qendrën Kulturorë në Prizren më 10 dhjetor, po ashtu si pjesë e projektit "Të Kuptuarit e Pasurisë së Diversitetit".



ETNO FAIR IN GRACANICA

HANDS THAT CREATE, HEARTS THAT CONNECT

At the beginning of December, the Cultural Centre in Gracanica hosted the Etno Fair "Hands That Create, Hearts That Connect", organized by the Avenija Association of Businesswomen. Women from different parts of Kosovo - Kosovo Serb (KOS), Kosovo Albanian (KOA), Kosovo Bosniak, Kosovo Roma and Kosovo Gorani, gathered in one place to present their work, traditions and entrepreneurial ideas.

The fair is part of the project "Understanding the Wealth of Diversity", which Avenija is implementing with the support of UNMIK. It was preceded by six workshops dedicated to developing women's entrepreneurship and fostering mutual understanding through practical work. The final session, focused on the theme "The Strength of Diversity in Entrepreneurship", brought together 20 women from across Kosovo who, through interactive activities, exchanged experiences, discussed challenges and learned how diversity can become an advantage.

Unity through work and tradition

Ramiza Shaipi from Gornja Ljubinja presented the weaving tradition of the Prizren region. "This is our tradition. Women weave traditional parts of the folk costume, which reach very high value on the market. It is important for women to work, to be diligent, strong and, most importantly, healthy," said Ramiza, showing the hand-woven pieces that attracted visitors' attention.

Gordana Toskic from Gracanica, a member of the women's association 'Ketering na kasiku' (Catering on a Spoon), said their idea was born from the desire to combine what they love with something that can generate income. "We want to work, to become economically empowered and to show that women are capable of so much. They just need to start and have a clear goal." She added that every such event is an invitation for other women to make a change. "We invite all women who want to work, who want to change something in their lives," Toskic emphasized.

Through shared heritage we build trust

The director of the organization "Hanuma", Shukrije Gori Markovic, emphasized that mutual understanding among people is essential for the stability and progress of Kosovo. She noted that the future is built on the foundations of mutual respect, open dialogue and the preservation of cultural identity. "Here in Kosovo, our strength lies in the richness of our cultures, customs and traditions that make us unique. When we celebrate multiethnicity together, we do not simply accept differences, we turn them into bridges that connect us. By celebrating what unites us, we send a clear message: through shared heritage we build trust, mutual respect and the foundations of a society in which everyone feels safe and valued. This is how we create a stronger, more stable and fairer future for all people in Kosovo," Shukrije stressed.

When cooperation grows into friendship Gordana Djoric, president of the Avenija Association of Businesswomen from Laplje Selo, agreed with this view. She emphasized that the workshops focused not only on products but also on relationships. "Women from all parts of Kosovo are here, KOS, KOA, Kosovo Roma, Kosovo Bosniak and Kosovo Gorani women are taking part. We worked together, learned, exchanged experiences and became friends. I believe that we will continue to work together in the future and achieve even more. Everything depends on women believing in themselves and their ideas." According to her, each participant brought what she had previously made, but now in an improved and higher-quality form, thanks to the training they received in the organization as well as their existing knowledge. Djoric said she is proud of the diversity of the products displayed, noting that visitors could see handicrafts, parts of traditional costumes, clothing items with etno motifs, as well as a rich selection of sweets and catering.

"Believe in yourself"

As for future plans, Djoric expects more support for all women in Kosovo because, in her words, they are the pillar of every society. "I hope we will receive more support from foundations and embassies that allocate funds for this. We want to work together, whether on the market or through new projects, and to secure certain equipment that would help women improve the quality of their products. Of course, our plan is also to organize more fairs like this, which allow these products to be presented." Djoric encouraged women to believe in themselves: "Everything depends on you. If you take a step toward your ideas, I am sure they will come true. It is important to believe in yourself and to begin."

Diversity of stands and joint cooperation

This fair was not only an exhibition of handicrafts, but also a shared framework of cooperation built through workshops and meetings. It was a space where women learned from one another, developed their entrepreneurial skills and created connections that could open new doors for them. The Etno Fair was also held at the Cultural Centre in Prizren on 10 December, also as part of the project "Understanding the Wealth of Diversity."

VENDET KU TOKA "MERR FRYMË" PLANETI QË KURRË NUK RRI NË GJENDJE TË QETË

Në shikim të parë, duket sikur Toka është e qetë dhe e qëndrueshme. Ne ecim mbi të, ndërtojmë qytete dhe e planifikojmë të ardhmen sikur asgjë nuk po ndodh poshtë nesh. Mirëpo, e vërteta është krejtësisht ndryshe. Thellë nën sipërfaqen e planetit diçka vazhdimisht vlon, lëvizë dhe çliron energji. Në disa vende, ky proces është aq i dukshëm sa duket sikur Toka në të vërtetë po merr frymë.

Gejzerët që nxjerrin ujë të nxehtë, çarjet që nxjerrin avull dhe vullkanet e baltës që ziejnë vazhdimisht tregojnë se planeti po ndryshon vazhdimisht formë. Këto janë disa nga vendet më të mahnitshme ku mund të shohim atë Tokë "të gjallë".

YELLOWSTONE - SHITETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Yellowstone e ka numrin më të madh të gejzerëve në botë. Më i famshmi, Old Faithful, nxjerr ujë të nxehtë dhe avull lart në ajër në intervale pothuajse të rregullta. Nën këtë park është një sistem i madh vullkanik që i ngroh ujërat nëntokësore dhe krijon shpërthime të fuqishme me avull. Nëse Yellowstone shpërthen me forcë të plotë, do të ishte një nga shpërthimet më të mëdha vullkanike në historinë e planetit, prandaj shkencëtarët po e monitorojnë nga afër çdo ditë.



Yellowstone - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

ZONAT GJEOTERMALE - ISLANDË

Islanda ndodhet në kufirin e dy pllakave tektonike, prandaj është plot me burime të nxehta, avull dhe gejzerë. Toka, nëse e prekim, është e ngrohtë në shumë vende dhe energjia nga brendësia e planetit përdoret për të ngrohur shtëpitë dhe pishinat. Në Islandë, vendasit shpesh lahen në burime natyrore të nxehta, madje edhe në borë e akull, një aventurë e vërtetë për vizitorët.



Zonat gjeotermale - Islandë

VULLKANET E BALTËS - AZERBAJXHAN

Azerbajxhani e ka më shumë se gjysmën e të gjitha vullkaneve të baltës në botë. Në vend të llavës, prej tyre dalin balta, uji dhe gazrat. Sipërfaqja duket sikur po zien, dhe flluskat vazhdimisht shfaqen dhe shpërthejnë. Edhe pse nuk duken të rrezikshme, disa nga këto vullkane mund të shpërthejnë papritur, gjersa njerëzit nga fshatrat përreth janë në dijeni për këtë dhe i përcjellin vazhdimisht.



Vullkanet e baltës - Azerbajxhan

SOLFATARET - ITALI


Në afërsi të Napolit ka solfatare, vrma nga të cilat dalin gazra squfuri dhe avull. Toka është e ngrohtë dhe aroma është shumë e fortë. Kjo zonë tregon se magma është afër sipërfaqes, megjithëse nuk ka shpërthim klasik. Romakët e lashtë besonin se solfataret ishin hyrja për në botën e nëndheshme dhe vendi ku perënditë "marrin frymë".



Solfataret - Itali

LUSI - INDONEZI

Lusi është një vullkan balte që për vite me radhë ka nxjerrë vazhdimisht sasi të mëdha balte. Ai është aq aktiv sa ka fundosur fshatra, rrugë dhe fusha, por gjithashtu i magjeps shkencëtarët. Lusi ka nxjerrë baltë për më shumë se 15 vite pa u ndalur; kjo është sikur Toka të ketë shatërvanin e vet që zgjat për dekada.



Lusi - Indonezi



Rotorua - Zelanda e Re

ROTORUA - ZELANDA E RE

Rotorua është një qytet i ndërtuar në një zonë gjeotermale. Avulli del nga toka, balta vlon, gjersa gejzerët shpërthejnë papritmas. Era e sqfurit është pjesë e jetës së përditshme të banorëve vendas. Në Rotorua, ushqimi ndonjëherë gatuhet duke përdorur nxehtësinë që vjen direkt nga toka, që është "një gatim i vërtetë nga toka".

DEPRESIONI I DANAKILIT - ETIOPI

Ky është një nga vendet më ekstreme në Tokë. Këtu, kontinenti vërtet po ndahet, gjersa korja e re e Tokës formohet ngadalë. Llava, gazrat dhe çarjet e krijojnë një peizazh që duket si një botë tjetër. Kjo zonë është një nga vendet më të nxehta e të banuara në botë, njerëzit vendas kanë mësuar si të mbijetojnë në temperatura që i kalojnë 50°C.



Depresioni i Danakil - Etiopi

TOKA NUK ËSHTË E HESHTUR - THJESHT RRALLË E DËGJOJMË ATË

Vendet ku Toka "merr frymë" na kujtojnë se bota nuk është statike. Malet, ishujt dhe kontinentet lindin dhe zhduken falë këtyre proceseve. Këto vende nuk janë vetëm pika interesante në hartë, ato janë provë se natyra ka forcë të madhe dhe e ka ritmin e vetë. Ndërsa ne bëjmë plane për nesër, Toka po e përgatit frymëmarrjen e saj të ardhshme. Mu ashtu siç ne marrim frymë edhe ajo "merr frymë" vazhdimisht, gjithmonë e gjallë, gjithmonë në lëvizje.

WHERE THE EARTH "BREATHES" A PLANET THAT NEVER RESTS

At first glance, it looks like the Earth is calm and stable. We walk on it, build cities and plan the future as if nothing is happening below us. But the truth is completely different. Deep below its surface the planet is constantly boiling, shifting and releasing energy. In some places, this process is so visible that it seems as if the Earth is literally - breathing.

Geysers spewing hot water, fissures spewing steam, and mud volcanoes constantly boiling show that the planet is constantly changing shape. These are some of the most amazing places where we can see the "living" Earth.

YELLOWSTONE - UNITED STATES OF AMERICA

Yellowstone has the largest number of geysers in the world. The most famous, Old Faithful, spews hot water and steam high into the air at almost regular intervals. Beneath the park is a huge volcanic system that heats the groundwater and creates powerful steam eruptions. If Yellowstone erupts in full force, it would be one of the largest volcanic eruptions in the history of the planet, so scientists are closely monitoring it every day.

GEOHERMAL AREAS - ICELAND

Iceland is located on the border of two tectonic plates, which is why it is full of hot springs, steam and geysers. The earth is warm to the touch in many places, and the energy from inside the planet is used to heat houses and swimming pools. In Iceland, locals often bathe in natural hot springs even in snow and ice, a real adventure for visitors!

MUD VOLCANOES - AZERBAIJAN

Azerbaijan has more than half of all mud volcanoes in the world. Instead of lava, mud, water and gases come out of them. The surface appears to be boiling, and bubbles keep appearing and bursting. Although they do not seem dangerous, some of these volcanoes can erupt suddenly, and people from the surrounding villages know this and are constantly watching.

SOLFATARA - ITALY

In the vicinity of Naples there are solfatara, holes from which sulphur gases and steam come out. The ground is warm and the smell is very strong. This area shows that the magma is near the surface, although there is no classic eruption. The ancient Romans believed that the solfatara were the

entrance to the underworld and the place where the gods "breathe".

LUSI - INDONESIA

Lusi is a mud volcano that has been continuously spewing huge amounts of mud for years. It is so active that it has submerged villages, roads and fields, but it also fascinates scientists. Lusi has been spewing mud for over 15 years without stopping, it's like the Earth has its own fountain that lasts for decades.

ROTORUA - NEW ZEALAND

Rotorua is a city built on a geothermal area. Steam rises from the ground, mud boils, and geysers suddenly erupt. The smell of sulphur is part of the daily life of local residents. In Rotorua, food is sometimes cooked using heat that comes directly from the earth, it's true "earth cooking".

DANAKIL DEPRESSION - ETHIOPIA

One of the most extreme places on Earth. Here, the continent is literally splitting apart, and the new Earth's crust is slowly forming. Lava, gases and fissures create a landscape that seems otherworldly. This area is one of the hottest permanently inhabited places in the world, the local people have learned how to survive in temperatures exceeding 50°C.

THE EARTH IS NOT SILENT - WE JUST RARELY LISTEN TO IT

Places where the Earth "breathes" remind us that the world is not static. Mountains, islands and continents arise and disappear thanks to these processes. These places are not just interesting points on the map, they are proof that nature has enormous strength and its own rhythm. While we plan for tomorrow, the Earth is already preparing its next breath. And just like we breathe, she is constantly "breathing", always alive, always in motion.



Materialet e nevojshme:

- Një filxhan kafeje bosh nga letra ose një filxhan i vjetër
- Ngjyrë akrilike kafe dhe e bardhë (nëse nuk keni ngjyrë kafe, mund ta fitoni atë duke përzier të verdhën, të kaltërtën dhe të kuqen - një eksperiment i vogël me ngjyra)
- Ngjytës i bardhë
- Letër për pjekje
- Shkop për përzierje

Procedura e përgatitjes:

Hapi 1: Përgatitja e ngjyrës kafe

Nëse po e bëni vetë ngjyrën kafe, atëherë filloni me sasi të vogla të së verdhës, së kaltërtës dhe së kuqes. Ngjyra e kaltër është një ngjyrë e fortë, prandaj kini kujdes të mos shtoni shumë sasi të saj. Përziejini derisa të merrni një nuancë të ngrohtë kafe. Nëse dëshironi që të duket si kafe me qumësht, atëherë shtoni pak ngjyrë të bardhë. Qëllimi është të fitoni një nuancë që i ngjan kafesë që pini në shtëpi, të errët, më të çelët, me më shumë ose më pak qumësht. Përziejini mirë në mënyrë që ngjyra të jetë homogjene, pa gjurmë të nuancave të tjera në skajet e gotës.

Hapi 2: Shtimi i ngjytës

Tani shtoni afërsisht të njëjtën sasi ngjytësi sa keni edhe ngjyra. Ngjytësi është çelësi sepse kur thahet, do të bëhet transparent dhe do t'i japë "kafesë" suaj një strukturë të fortë, paksa gome. Ndërsa e përzieni, masa do të duket më e çelët, kjo është normale, pasi ngjytësi


DO IT YOURSELF



SI TË PËRGATISNI NJË "KAFFE TË DERRDHUR" SI SHAKA TË 1 PRILLIT?

Dita e Gënjeshtërave festohet çdo vit më 1 prill dhe i kushtohet së qeshurës, kreativitetit dhe shakave të padëmshme. Ajo është një ditë kur lejohen dredhi të vogla dhe humori është në rend të parë, nga truket e thjeshta si ndërrimi i sheqerit me kripën, kafeja e derdhur deri te shakatë imagjinative dhe të planifikuara me kujdes. Gjëja më e rëndësishme është që shakatë të jenë të padëmshme dhe që në fund të gjithë, përfshirë atë që ishte shënjestra, të mund të qeshin vërtet.

Ky zakon ka ekzistuar prej shekujsh. Disa historianë e shoqërojnë atë me festivale të vjetra romake plot argëtim dhe shaka, ndërsa të tjerë besojnë se buron nga periudha mesjetare, kur data e festimit të Vitit të Ri u ndryshua. Pavarësisht nga origjina e saj e vërtetë, Dita e Gënjeshtërave ose 1 Prilli është një traditë e dashur në të gjithë botën sot. Nëse jeni duke e kërkuar një shaka krijuese, të padëmshme dhe, do të pajtoheni vërtetë, një shaka efektive për 1 Prill, atëherë kjo ide është e qëlluar. Domethënë, "kaf- eja e derdhur" duket plotësisht realiste, por në të vërtetë është e bërë me ngjyrë dhe ngjytës. Mbi të gjitha, mund ta përdorni disa herë dhe ta vendosni pothuajse kudo.



është i bardhë. Pas tharjes, ngjyra do të kthehet në nuancën natyrale. Përzieni derisa të keni një masë të lëmuar dhe të trashë pa kokrra.

Hapi 3: Krijimi i një pellgu "derdhjeje"

Më pas, prisni copën e letrës për pjekje dhe vendoseni në një sipërfaqe të sheshtë. Ngadalë derdhni masën mbi letër në mënyrë që të duket sikur kafeja sapo është derdhur nga filxhani. Mos bëni një rreth të përsosur sepse kafeja e vërtetë derdhet në mënyrë të çrregullt. Mund t'i tërhiqni pak skajet me një shkop, të lini "valë" natyrale dhe të bëni pika të vogla shtesë anash, sepse sa më e çrregullt derdhja aq më realiste duket.

Hapi 4: Tharja

Kjo është pjesa më e rëndësishme e durimit. Lëreni të thahet për të paktën disa ditë. Skajet do të thahen

më shpejt se mesi. Nëse përpiqeni ta shpëputni më herët, mund të grisët. Kur të jetë tharë plotësisht, filloni t'a qëroni me kujdes nga letra, bëjeni ngadalë që të mos çahet dhe nëse vini re se mesi është ende i butë, atëherë kthejeni që të thahet për një ose dy ditë të tjera. Kur të jetë gati, do të keni një "njollë" fleksibile nga goma, që duket çuditërisht bindëse.

Tani vjen pjesa argëtuese! Vendoseni "kafenë e derdhur" në tryezën e kuzhinës ose në tavolinën e punës, ndoshta pranë laptopit ose në tavolinën e dhomës së ndenjes. Qëndroni mënjanë dhe shikoni reagimin. Në fillim, pothuajse të gjithë besojnë se është kafe e vërtetë. Gjithsesi mos harroni, një shaka e vërtetë është ajo me të cilën të gjithë qeshin dhe askush nuk ndihet i turpëruar ose i lënduar. Gati për 1 Prillin? 😊

Shpresojmë që ju pëlqeu ky propozim i yni. Nëse edhe ju keni ndonjë ide, na shkruani në: magazineforyou2003@gmail.com dhe ndani përvojën tuaj me ne.

DO IT YOURSELF



HOW TO MAKE A "SPILLED COFFEE" APRIL FOOLS' PRANK?

April Fools' Day is celebrated every year on April 1st and is dedicated to laughter, creativity, and harmless pranks. It's a day when small tricks are allowed and humor takes center stage, from simple gags like switching sugar and salt or fake spilled coffee, to imaginative and carefully planned jokes. The most important thing is that the pranks remain good-natured and that, in the end, everyone, including the person who was the target, can share a genuine laugh.

This tradition has existed for centuries. Some historians link it to ancient Roman festivals filled with laughter and playful tricks, while others believe it dates back to the Middle Ages, when the date of New Year's celebrations changed. Regardless of its true origin, April Fools' Day is now a beloved tradition around the world. If you're looking for a creative, harmless, and, you'll agree, very effective prank for April 1st, this idea is a perfect choice. The "spilled coffee" looks completely realistic, yet it's actually made from paint and glue. Best of all, you can reuse it multiple times and place it almost anywhere.

Materials needed:

- An empty paper coffee cup or an old mug
- Brown and white acrylic paint (If you don't have brown, you can make it by mixing yellow, blue, and red, a small color-mixing experiment!)
- White glue
- Baking paper
- A mixing stick

Production process:

Step 1: Preparing the coffee color

If you're making the brown color yourself, start with small amounts of yellow, blue, and red. Blue is very strong, so be careful not to add too much. Mix until you get a warm brown shade. If you want it to look like coffee with milk, add a bit of white paint. The goal is to create a tone that resembles the kind of coffee you drink at home, darker, lighter, with more or less milk. Mix well so the color is smooth and even, without streaks of other shades along the edges of the cup.

Step 2: Adding the glue

Now add approximately the same amount of glue as the amount of paint you have. The glue is essential because, once it dries, it becomes transparent and gives your "coffee" a firm, slightly rubbery texture. As you mix, the mixture will look lighter, that's normal, since the glue is white. After it dries, the color will return to a



more natural shade. Mix until you get a smooth, thick consistency without any lumps.

Step 3: Creating the "spilled" puddle

Then cut a piece of baking paper and place it on a flat surface. Slowly pour the mixture onto the paper so it looks as if the coffee has just spilled from the cup. Avoid making a perfect circle, because real coffee spreads in an irregular shape. You can gently pull the edges outward with a stick, leave natural "waves," and add a few small droplets around the puddle, the more uneven it is, the more realistic it will look.

Step 4: Drying

This is the most important part, patience. Let it dry for at least a few days. The edges will dry faster than the center. If you try to peel

it off too early, it may tear. When it's completely dry, carefully start lifting it from the paper, doing it slowly so it doesn't crack. If you notice that the center is still soft, put it back and let it dry for another day or two. Once it's fully done, you'll have a flexible, rubbery "stain" that looks surprisingly convincing.

Now comes the fun part! Place the "spilled coffee" on the kitchen table or a desk with papers, maybe next to a laptop or on the coffee table in the living room. Step aside and watch the reaction. In that first moment, almost everyone believes it's real coffee. And remember, the best prank is the one everyone can laugh at, where no one feels uncomfortable or hurt. Ready for April Fools' Day? 😊

We hope you enjoyed our suggestion. If you have an idea of your own, feel free to write to us at: magazineforyou2003@gmail.com and share your experience with us.



PESË FILMA QË E BËJNË PRILLIN MË TË NDRITSHËM, MË TË GUXIMSHËM DHE PLOT AVENTURË

Prilli sjell ditë më të gjata, energji të freskët dhe ndjesinë se histori të reja po presin pas këndit. Përzgjedhja e filmave të këtij muaji përzien botë fantazie, legjenda të jetës reale, aksion intensiv dhe komedi të lehtë. Nga galaktika të largëta te Italia me diell, deri te arenat sportive, këta filma ofrojnë emocion, ndjenja dhe frymëzim për çdo lloj shikuesi.



THE SUPER MARIO GALAXY

 **Zhanri:** Animacion / Familjar / Aventurë

 **Aktorët:** Chris Pratt, Anya Taylor Joy, Jack Black, Keegan Michael Key, Kevin Michael Richardson

Pse duhet ta shikoni:

Bota e Mario-s rikthehet me një aventurë të gjallëruar plot ngjyra që zgjeron universin që fansat tashmë e duan. I mbushur me humor, aksion dhe planeta imagjinare, filmi e ruan shpirtin lozonjar të lojërave ndërsa tregon një histori të re për miqësinë dhe guximin. Një zgjedhje ideale si për fansat e vjetër ashtu edhe për shikuesit më të rinj.




STAR WARS: MAUL - SHADOW LORD

 **Zhanri:** Animacion / Aksion / Fanta-shkencë

 **Aktorët:** Sam Witwer, Gideon Adlon, Wagner Moura, Richard Ayoade

Pse duhet ta shikoni:

I vendosur pas ngjarjeve të The Clone Wars, historia ndjek Maul ndërsa ai përpaket të rindërtojë perandorinë e tij kriminale në një planet të harruar. Aty ai e takon Jedi Padawan-in e ri që mund të bëhet ose nxënësi i tij ose armiku i tij. Një histori më e errët e Star Wars plot tension, mister dhe hakmarrje.



4 KIDS WALK INTO A BANK

 **Zhanri:** Aventurë / Komedi / Krim

 **Aktorët:** Liam Neeson, Teresa Palmer, Jim Sturgess, Jack Dylan Grazer, Deacon Phillippe

Pse duhet ta shikoni:

Kur kriminelët e detyrojnë babanë e saj të bëjë një punë të fundit të paligjshme, Paige vendos të veprojë e para. Së bashku me tre miqtë e saj më të mirë, ajo e planifikon një mision të çmendur për të ndaluar grabitjen para se ajo të ndodhë. Një aventurë argëtuese dhe e zgjuar që e përzien humorin, ngazëllimin dhe kreativitetin rinor.



BEAST

Zhanri: Aksion / Dramë / Sport

Aktorët: Daniel MacPherson, Luke Hemsworth, Bren Foster, Amy Shark, Mojean Aria, Russell Crowe

Pse duhet ta shikoni:

Një ish kampion i MMA rikthehet në kafaz kur jeta e vëllait të tij rrezikohet. Duke u stërvitur sërish me trajnerin e vjetër, ai përballet me një kundërshtar brutal në një luftë të fundit që mund të përcaktojë trashëgiminë e tij. Një histori për vendosmëri, sakrificë dhe për të mos u dorëzuar kurrë.



YOU, ME & TUSCANY

Zhanri: Komedi romantike

Aktorët: Halle Bailey, Regé Jean Page, Aziza Scott, Lorenzo de Moor, Marco Calvani

Pse duhet ta shikoni:

Anna e ka humbur drejtimin në jetë derisa një mundësi e papritur e çon në Itali. Në Toskanë ajo zbulon miqësi të reja, ëndrra të reja dhe ndoshta edhe dashurinë. Një film i ngrohtë dhe relaksues për shanset e dyta dhe guximin për të ndjekur pasionin.

FIVE FILMS THAT MAKE APRIL BRIGHTER, BOLDER, AND FULL OF ADVENTURE

April brings longer days, fresh energy, and the feeling that new stories are waiting around the corner. This month's film selection mixes fantasy worlds, real life legends, intense action, and lighthearted comedy. From galaxies far away to sunny Italy and sports arenas, these films offer excitement, emotion, and inspiration for every type of viewer.

THE SUPER MARIO GALAXY

Genre: Animated / Family / Adventure

Cast: Chris Pratt, Anya Taylor Joy, Jack Black, Keegan Michael Key, Kevin Michael Richardson

Why you should watch it:

The world of Mario returns with a colorful animated adventure that expands the universe fans already love. Filled with humor, action, and imaginative planets, the film keeps the playful spirit of the games while telling a new story about friendship and courage. A perfect choice for both long-term fans and younger viewers.

Why you should watch it:

When criminals force her father into one last illegal job, Paige decides to act first. Together with her three best friends, she plans a wild mission to stop the robbery before it even happens. A fun and clever adventure mixing humor, suspense, and youthful creativity.

BEAST

Genre: Action / Drama / Sports

Cast: Daniel MacPherson, Luke Hemsworth, Bren Foster, Amy Shark, Mojean Aria, Russell Crowe

Why you should watch it:

A former MMA champion returns to the cage when his brother's life is threatened. Training again with his old coach, he faces a brutal opponent in one final fight that could define his legacy. A story about determination, sacrifice, and never giving up.

STAR WARS: MAUL – SHADOW LORD

Genre: Animated / Action / Sci Fi

Cast: Sam Witwer, Gideon Adlon, Wagner Moura, Richard Ayoade

Why you should watch it:

Set after the events of The Clone Wars, the story follows Maul as he tries to rebuild his criminal empire on a forgotten planet. There he meets a young Jedi Padawan who could become either his student or his enemy. A darker Star Wars story full of tension, mystery, and revenge.

YOU, ME & TUSCANY

Genre: Romantic Comedy

Cast: Halle Bailey, Regé Jean Page, Aziza Scott, Lorenzo de Moor, Marco Calvani

Why you should watch it:

Anna has lost direction in life until an unexpected opportunity takes her to Italy. In Tuscany she discovers new friendships, new dreams, and maybe even love. A warm and relaxing film about second chances and the courage to follow your passion.

4 KIDS WALK INTO A BANK

Genre: Adventure / Comedy / Crime

Cast: Liam Neeson, Teresa Palmer, Jim Sturgess, Jack Dylan Grazer, Deacon Phillippe

KUPA E BOTËS E FIFA 2026 VENDOS NJË STANDARD TË RI GLOBAL - NJË TURNE MË I MADH SE KURRË

Më 11 qershor 2026, edicioni më i madh në histori i Kupës së Botës së FIFA do të nisë në Amerikën e Veriut. Për gjashtë javë, nga 11 qershori deri më 19 korrik, 48 përfaqësuese kombëtare do të garojnë në një turne që shtrihet në tri shtete dhe 16 qytete pritëse. Më shumë se 6.5 milionë tifozë pritet t'i ndjekin ndeshjet në stadione, duke e bërë këtë një nga ngjarjet sportive më të mëdha të organizuara ndonjëherë.



Një Kupë Bote me 48 ekipe

Ndryshimi më i rëndësishëm në vitin 2026 është i thjeshtë, por me ndikim të madh. Turneu zgjerohet nga 32 në 48 ekipe. Ky vendim i vetëm ndryshon gjithçka. Me më shumë ekipe pjesëmarrëse, FIFA e ka ridizajnuar strukturën e garës. Në vend të tetë grupeve, tani do të ketë 12 grupe me nga katër ekipe. Dy ekipet e para në secilin grup do të kualifikohen, por jo vetëm ato. Tetë ekipet më të mira të vendeve të treta do të avancojnë gjithashtu, duke e krijuar një fazë të re me 32 skuadra përpara fazës tradicionale të 16 më të mirave. Prej aty, turneu vazhdon me çerekfinale, gjysmëfinale, ndeshjen për vendin e tretë dhe finalen.

Zgjerimi ndryshon edhe mënyrën se si ndahen vendet kualifikuese në nivel botëror. Meqë 16 ekipe shtesë duhet të kualifikohen, çdo konfederatë përfiton më shumë vende. Evropa i ka 16 vende të drejtpërdrejta, Afrika nëntë, Azia tetë, Amerika e Jugut gjashtë, Amerika e Veriut, Qendrore dhe Karaibet gjashtë, përfshirë tri shtetet organizatore, Oqeania e ka një vend të garantuar, ndërsa dy vende të tjera do të vendosen përmes një turneu ndërkontinental

“play off”. Në terma praktikë, kjo do të thotë se më shumë përfaqësuese nga rajone të ndryshme do të garojnë në skenën globale. Për ekipet në zhvillim, kualifikimi bëhet më i arritshëm. Për fuqitë tradicionale, rruga drejt trofeut bëhet më e gjatë dhe më kërkuese.

Shtirje kontinentale: qytetet, klima dhe përmasat

Turneu i vitit 2026 do të zhvillohet në Kanada, Meksikë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke krijuar një ngjarje vërtet kontinentale. Në Kanada, ndeshjet do të luhen në Toronto dhe Vancouver. Në Meksikë, ndeshjet do të zhvillohen në Guadalajara, Mexico City dhe Monterrey. Kurse, në Shtetet e Bashkuara, qytetet nikoqire janë: Atlanta, Boston, Dallas, Houston, Kansas City, Los Angeles, Miami, New York New Jersey, Philadelphia, Seattle dhe zona e Gjirit të San Franciscos. Distancat mes disa prej këtyre qyteteve janë shumë të mëdha. Ekipet dhe tifozët do të udhëtojnë mijëra kilometra gjatë turneut. Kushtet klimatike do të kenë gjithashtu ndikim. Qershori dhe korriku në pjesë të Amerikës së Veriut mund të sjellin temperatura të

larta, lagështi dhe herë pas here stuhi verore. Menaxhimi i udhëtimeve, rikuperimit dhe përshtatjes me klimën do të jetë pjesë e rëndësishme e përgatitjes së çdo ekipi. Përmasat e



këtij edicioni e dallojnë atë nga çdo Kupë Bote e mëparshme.

Ëndrra e Kosovës vazhdon

Në momentin e publikimit të këtij artikulli, Kosova mbetet në garë për një vend në Kupën e Botës 2026 përmes rrugës evropiane të “play off”-it. Skuadra përballlet me Sllovakinë, ndërsa Turqia dhe Rumania ndeshen në gjysmëfinalen tjetër. Fituesi i këtyre përballjeve do të kualifikohet në turneun final dhe do t'i bashkohet një grupi që i përfshin Shtetet e Bashkuara, Paraguajin dhe Australinë.

Kosova arriti në këtë fazë pasi përfundoi e dyta pas Zvicrës në grupin kualifikues, vetëm tri pikë larg kualifikimit të drejtpërdrejtë. Paraqitjet e forta brenda dhe jashtë fushe, përfshirë fitoret ndaj Suedisë, theksuan pjekurinë në rritje dhe stabilitetin konkurrues të ekipit.





Dy ndeshje vendimtare e ndajnë Kosovën nga një paraqitje e parë historike në Kupën e Botës. Rezultati do të tregojë nëse progresi i fundit do të përkthet në kualifikim në skenën më të madhe të futbollit.

Një epokë e re për futbollin global
Zgjerimi në 48 ekipe bën më shumë sesa thjesht rrit numrat. Ai ndryshon ritmin dhe strategjinë e turneut. Thellësia e skuadrës bëhet më e rëndësishme. Koha e rikuperimit mes ndeshjeve bëhet vendimtare. Trajnerët duhet të balancojnë ambicien me menaxhim të zgjuar. Çdo pikë në fazën e grupeve ka peshë më të madhe, sidomos me mundësinë e kualifikimit si një nga ekipet më të mira të vendeve të treta. Kupa e Botës 2026 nuk do të jetë thjesht më e madhe. Ajo do të jetë ndryshe në karakter, gjeografi dhe balancë konkurruese. Një kapitull i ri nis në Amerikën e Veriut, i përcaktuar nga risi historike dhe një format që riformëson të ardhmen e turneut.

Fakte të shpejta për Kupën e Botës 2026

- Botërori i parë me 48 ekipe
- Botërori i parë me tri shtete nikoqire
- 16 qytete nikoqire në Amerikën e Veriut
- Prezantimi i fazës me 32 skuadra
- Më shumë se 6.5 milionë spektatorë të pritur
- Distancat më të gjata të udhëtimit në historinë e Kupës së Botës

2026 FIFA WORLD CUP SETS A NEW GLOBAL STANDARD - A TOURNAMENT BIGGER THAN EVER

On 11 June 2026, the largest FIFA World Cup in history will begin across North America. Over six weeks, from 11 June to 19 July, 48 national teams will compete in a tournament that stretches across three countries and 16 host cities. More than 6.5 million fans are expected to attend matches, making it one of the biggest sporting events ever organized.

A World Cup of 48 teams

The most important change in 2026 is simple but powerful. The tournament expands from 32 to 48 teams. That single decision reshapes everything. With more teams involved, FIFA has redesigned the structure of the competition. Instead of eight groups, there will now be 12 groups of four teams. The top two teams in each group will advance, but they will not be alone. The eight best third-placed teams will also move forward, creating a brand-new round of 32 before the traditional round of 16. From there, the tournament continues through the quarter finals, semifinals, a third-place match and the final.

The expansion also changes how places are distributed around the world. Because 16 additional teams must qualify, every confederation receives a larger share. Europe now has 16 direct spots. Africa has nine. Asia has eight. South America has six. North and Central America and the Caribbean have six, including the three host nations. Oceania has one guaranteed place, and two more tickets will be decided through an intercontinental play off tournament.

In practical terms, this means more nations from different regions will compete on the global stage. For emerging teams, the door is wider than ever. For traditional powers, the path to the trophy becomes longer and more demanding.

Across a continent: cities, climate and scale

The 2026 tournament will unfold across Canada, Mexico and the United States, creating a truly continental event. In Canada, matches will be played in Toronto and Vancouver. In Mexico, games will take place in Guadalajara, Mexico City and Monterrey. In the United States, host cities include Atlanta, Boston, Dallas, Houston, Kansas City, Los Angeles, Miami, New York New Jersey, Philadelphia, Seattle and the San Francisco Bay Area. This means that the distances between some of these cities are enormous. Teams and supporters will travel thousands of kilometers during the tournament. Weather conditions will also play a role. June and July in parts of North America can bring high temperatures, humidity and occasional summer storms. Managing travel, recovery and climate adaptation will be an

important part of every team's preparation. The scale of this edition makes it different from any previous World Cup.

Kosovo's dream still alive

As this article goes to publication, Kosovo remains in contention for a place at the 2026 FIFA World Cup through the European playoff path. The team faces Slovakia, while Turkey and Romania meet in the other semifinal. The winner of this bracket will advance to the final tournament and join a group that includes the United States, Paraguay and Australia. Kosovo reached this stage after finishing second behind Switzerland in its qualifying group, just three points short of direct qualification. Strong performances at home and away, including victories against Sweden, underlined the team's growing maturity and competitive stability. Two decisive matches now separate Kosovo from a first World Cup appearance. The outcome will determine whether recent progress translates into qualification for football's biggest stage.

A new era for global football

The expansion to 48 teams does more than increase numbers. It changes the rhythm and strategy of the tournament. Squad depth becomes more important. Recovery time between matches becomes critical. Coaches must balance ambition with smart management. Every point in the group stage carries greater weight, especially with the possibility of advancing as one of the best third placed teams. The 2026 World Cup will not simply be larger. It will be different in character, geography and competitive balance. A new chapter begins in North America, one defined by historic firsts and a format that reshapes the future of the tournament.

World Cup 2026 Fast Facts

- First World Cup with 48 teams
- First tournament hosted by three nations
- 16 host cities across North America
- Introduction of a round of 32
- More than 6.5 million expected stadium spectators
- Longest travel distances in World Cup history

'MUST-HAVE' DIGJITAL: ABONIMET QË TA LEHTËSOJNË JETËN

Nëse mendoni se bota digjitale është vetëm TikTok dhe Instagram, gaboheni. Abonimet janë bërë një pjesë e vërtetë e jetës së përditshme, ato mund ta zbukurojnë ditën, t'ju argëtojnë, t'ju ndihmojnë të mësoni më shpejt, të zhvilloni aftësi dhe të zbuloni gjëra të reja. Por si ta dini cilat abonime ia vlejnë paratë tua dhe cilat janë vetëm humbje kohe e buxheti? Mos u shqetësoni, ne jemi këtu për t'ju treguar opsionet e vërteta "must-have" për çdo adoleshent që dëshiron të përfitojë maksimumin nga interneti.



Xbox Game Pass, PlayStation Plus dhe Nintendo Switch Online ju japin qasje në qindra lojëra. Kjo do të thotë se mund të provoni një mori titujsh të rinj pa qenë nevoja ta blini secilin veçmas.

EDUKIMI DHE MËSIMI - MËSONI MË MENÇUR

Njerëzit që ushtrojnë çdo ditë nga 15 minuta në Duolingo mund të mësojnë një gjuhë krejtësisht të re brenda një viti! Abonimet nuk janë vetëm për argëtim. Platforma si Duolingo Plus, Khan Academy, Skillshare apo MasterClass mund t'ju ndihmojnë të mësoni më shpejt dhe në mënyrë më interesante. Mësimi i gjuhëve, programimi, vizatimi apo montazhi i videove, gjithçka është e disponueshme në majë të gishtave. Një botë e tërë njohurish, vetëm një klik larg.

MUZIKA DHE PODKASTET - KOLONA ZANORE E JETËS SUAJ

Imagjinoni një ditë pa muzikë... e pamundur, apo jo. Abonimet në shërbime si Spotify, Apple Music ose YouTube Music ju lejojnë të kaloni këngët sa të doni, të krijoni playlistat tuaja dhe të zbuloni muzikë nga e gjithë bota. Ideale për rrugën drejt shkollës, ushtrime ose thjesht relaks në shtëpi. E për ata që duan të mësojnë duke qeshur, menduar ose thjesht duke dëgjuar histori interesante, podcastet janë zgjedhja perfekte. Abonimet si Spotify Premium ose Audible ju japin qasje në episode ekskluzive dhe përmbajtje pa reklama. Spotify i shton mbi 60.000 këngë të reja çdo muaj, që do të thotë se nuk do të mbeteni kurrë pa hite të reja!

PLATFORMAT E STREAMING-UT PËR FILMA DHE SERI - BINGE-WATCH PA FUND

Episoda e parë e Stranger Things pati mbi 14 milionë shikime vetëm në katër ditë, pra, të gjithë e panë! Prandaj, nëse e doni botën e filmave dhe serialeve, Netflix, Disney+, HBO Max dhe Prime Video janë aleatët tuaj më të mirë. Nga klasikët kult deri te premierat më të reja, gjithçka është aty, gati t'ju argëtojë

kur të doni dhe ku të doni.

ABONIMET E LOJËRAVE - LUANI PA KUFIZIME

Organizoni mbrëmje lojërash me miqtë, gjithmonë është më argëtuese së bashku, dhe mund të provoni lojëra që ndoshta nuk do t'i kishit zgjedhur kurrë vetë. Pikërisht për këtë, abonimet për lojëra janë një zbulim i vërtetë për çdo gamer.

ABONIMET KREATIVE - ZHVILLONI AFTËSITË TUAJA

Nëse vizatoni, montoni video apo kompozoni muzikë, abonimet kreative si Canva Pro, Adobe Creative Cloud ose Procreate janë zgjedhja ideale. Ato ju mundësojnë të krijoni përmbajtje me cilësi profesionale, një hap i parë i shkëlqyer drejt kanalit tuaj në YouTube,





profilin në Instagram apo edhe një karriere të ardhshme në industrinë kreative. Shumë YouTuber-a të njohur kanë filluar me mjete falas, por abonimi në mjete profesionale e ka përshpejtuar suksesin e tyre.

Abonimet mund të jenë super të dobishme, por zgjidhni me mençuri. Muzika, serialet, lojërat, mësimi dhe kreativiteti mund t'ju lehtësojnë jetën, t'ju argëtojnë dhe t'ju ndihmojnë të zhvilloheni. Gjeni shërbimet tuaja të preferuara, shfrytëzoni të gjitha funksionet dhe shijoni botën digjitale plot mundësi. Një adoleshent mesatar sot i ka 3 deri në 5 abonime, por vetëm ato që përdoren rregullisht ia vlejnë paratë. Prandaj bëni një listë, testoni opsionet dhe mbani vetëm ato që ju frymëzojnë dhe ju argëtojnë me të vërtetë.

RREZIQET E ABONIMEVE

- ÇFARË DUHET TË DINI

- Shpenzime të tepërta -

Shumë abonime duken të lira, por kur i ke 4-5 njëkohësisht, fatura mujore rritet shpejt.

Prandaj ndiqni sa shpenzoni çdo muaj dhe zgjidhni vetëm ato që i përdorni me të vërtetë.

- Rinovimi automatik -

Shumica e shërbimeve rinovohen vetë, ndaj mund të përfundoni duke paguar për diçka që keni harruar ta anuloni.

- Varësia nga ekrani - Shumë seri, lojëra ose TikTok mund të ndikojnë te gjumi, përqendrimi dhe koha që kaloni jashtë shtëpisë.

- Privatësia dhe siguria -

Abonimet shpesh kërkojnë të dhënat e kartës. Sigurohuni të përdorni shërbime të sigurta dhe të mos ndani informacione me faqe të panjohura.

DIGITAL 'MUST-HAVE': SUBSCRIPTIONS WHICH MAKE YOUR LIFE EASIER

If you think that the digital world is only TikTok and Instagram, you are wrong, subscriptions have become a real thing that can brighten up your everyday life, entertain you and help you learn faster, develop skills and discover new things. But how do you know which subscriptions are worth your pocket and which are just a waste of money? Don't worry, we're here to show you the real must-have options for all teenagers who want to get the most out of the internet.

MUSIC AND PODCASTS - THE SOUNDTRACK OF YOUR LIFE

Imagine a day without music... impossible, right? Subscriptions to services like Spotify, Apple Music or YouTube Music allow you to skip songs as much as you want, create your own playlists and discover music from around the world. Ideal for the road to school, exercising or chilling at home. And for those who like to learn while laughing or thinking, podcasts are the right thing. Subscriptions to Spotify Premium or Audible give you access to exclusive episodes and ad-free content. Spotify adds more than 60,000 new songs per month, so you'll never run out of new hits!

STREAMING SERVICES FOR FILMS AND SERIES - ENDLESS BINGE-WATCH

The first episode of Stranger Things had over 14 million views in just four days, so everyone watched! So, if you like to watch series and movies, Netflix, Disney+, HBO Max and Prime Video are your best allies. From cult classics to the latest premieres, it's all here, ready to entertain you anytime, anywhere.

GAMING SUBSCRIPTIONS - PLAY WITHOUT LIMITS

Organize gaming nights with friends, it's always more fun together, and you can try games that you would never try alone. That's why subscriptions are a real find for gamers. Xbox Game Pass, PlayStation Plus and Nintendo Switch Online give access to hundreds of games. This means you can try out a bunch of new games without having to buy each one separately.

EDUCATION AND LEARNING - STUDY SMARTER

People who practice 15 minutes a day on Duolingo can learn a whole new language in a year! Subscriptions aren't just for fun! Platforms like Duolingo Plus, Khan Academy, Skillshare or MasterClass can help you learn faster and more interestingly. Language learning, coding, drawing or video editing are all available at your fingertips.

CREATIVE SUBSCRIPTIONS - DEVELOP YOUR SKILLS

If you draw, edit video or compose music, creative subscriptions like Canva Pro, Adobe Creative Cloud or Procreate are the way to go. They allow you to create professional-quality content, which can be the first step towards your YouTube channel, Instagram profile or even a future job in the creative industry. Many popular YouTubers started with free tools, but subscribing to professional tools accelerated their success.

Subscriptions can be super useful, but choose wisely. Music, series, games, learning and creativity, all these can make your life easier, entertain you and help you. Find your favorite services, use all the functions and enjoy the digital world full of possibilities. The average teenager today has 3 to 5 subscriptions, but only the ones they use regularly are really worth the money. So make a list, test and keep what really inspires and entertains you.

THE DANGERS OF SUBSCRIPTIONS

- WHAT YOU NEED TO KNOW

- Excessive charges -

Many subscriptions are small in price, but when you have 4-5 at once, the monthly bill can be large. So, keep track of how much you spend per month and choose only what you actually use.

- Automatic renewal -

Most services renew automatically, so you may be paying for something you forgot to cancel.

- Screen Addiction -

Too many series, games or TikTok can affect sleep, concentration and time spent outside the home.

- Privacy and security -

Subscriptions often ask for card details. Make sure you use secure services and don't share information with unknown websites.

ZGJEDHJE TË QETA, JETË MË TË SIGURTA

Në jetën tonë të përditshme, çdo ditë bashkëbisedojmë me njëri-tjetrin. Flasim me miq, shokë klase, fqinj dhe të panjohur. Rrijmë në radhë, bëjmë pyetje, ndajmë hapësira dhe zgjidhim së bashku situata të vogla. Shumica e këtyre bashkëbisedimeve janë të thjeshta dhe përfundojnë pa asnjë problem. Por mënyra se si sillemi në këto momente ka rëndësi. Reagimet e qeta ose agresive mund të ndikojnë në mënyrën se si zhvillohen situatat, sa të sigurt ndihen njerëzit dhe nëse tensionet e vogla mbeten të vogla apo kthehen në diçka më të vështirë për t'u kontrolluar. Ndonjëherë, bashkëbisedimet tona të përditshme përfshijnë edhe kontakt me persona që përfaqësojnë shërbime apo autoritete të ndryshme. Në shumicën e rasteve, këto momente kalojnë shpejt dhe qetë, por jo gjithmonë. Megjithatë, sa herë që ato përshkallëzohen, është e qartë se gjërat mund të kishin përfunduar ndryshe nëse të gjithë të përfshirët do të kishin arritur të qëndronin të qetë.

Pse ka rëndësi kjo për gjeneratën tuaj?

Të rinjtë vëzhgojnë se si sillen të rriturit dhe figurat me autoritet. Ata vënë re se si trajtohen problemet në hapësirat publike dhe online. Këto përvoja formojnë mënyrën se si ndërtohet ose humbet besimi me kalimin e kohës. Kur bashkëbisedimet janë të qeta dhe me respekt, njerëzit ndihen më të sigurt. Ata janë më të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Mospajtimet nuk zhduken, por trajtohen pa frikë ose dhunë. Kjo nuk do të thotë se çdo situatë është e lehtë ose perfekte. Do të thotë se drejtësia, respekti dhe vetëkontrolli ndihmojnë në parandalimin e problemeve para se ato të rriten.

Bashkëbisedimet e përditshme kanë rëndësi

Keqkuptimet e vogla janë pjesë normale e jetës. Stresi, frika, lodhja ose komunikimi i paqartë mund të ndryshojnë mënyrën se si ndihet një situatë. Kur emocionet



rriten, edhe një bashkëbisedim i thjeshtë mund të duket papritur i pakëndshëm ose i padrejtë. Shumica e problemeve serioze nuk fillojnë papritur. Ato shpesh rriten nga keqkuptime të vogla, stres ose frikë. Një ton i ngritur, një reagim i nxituar, fjalë të paqarta ose ndjenja e trajtimit të padrejtë mund të rrisin emocionet nga të gjitha palët. Kur njerëzit ndihen të tensionuar, komunikimi bëhet më i vështirë. Dëgjimi bëhet sfidues.

Supozimet zëvendësojnë mirëkuptimin. Kështu momentet e vogla mund të kthehen ngadalë në probleme më të mëdha. Sjellja e qetë ndihmon në ngadalësimin e situatës. Ajo u jep njerëzve kohë të kuptojnë çfarë po ndodh dhe të përgjigjen qartë. Kjo mund të parandalojë që një situatë e thjeshtë të shndërrohet në konflikt.

Si ndikon sjellja në rezultatet?

Mënyra se si flasim, dëgjojmë dhe reagojmë

ka ndikim real. Toni ka rëndësi. Fjalët kanë rëndësi. Gjuha e trupit ka rëndësi. Këto detaje të vogla mund të ulin tensionin ose ta rrisin atë. Sjellja e qetë nuk do të thotë të pajtohesh me gjithçka apo të heqësh dorë nga qëndrimi yt. Do të thotë të mbetesh i respektueshëm dhe i përqendruar, edhe kur situata është e pakëndshme. Do të thotë të zgjedhësh fjalët me kujdes dhe t'u japësh të tjerëve hapësirë të shpjegojnë. Kur sjellja mbetet e qetë dhe e qëndrueshme, njerëzit ndihen më të sigurt. Ata kanë më shumë gjasa të dëgjojnë, të bashkëpunojnë dhe të gjejnë zgjidhje. Kur sjellja bëhet agresive ose nënvlerësuese, emocionet rriten dhe besimi zhduket. Shumë konflikte mund të shmangeshin nëse njerëzit do të ndaleshin për një moment para se të reagonin.

Veprimet e vogla bëjnë ndryshim të madh

Dhuna zakonisht nuk fillon me veprime të mëdha. Ajo shpesh nis me zgjedhje të vogla. Të flasësh qetë në vend që të bërtasësh. Të dëgjosh në vend që të ndërpresësh. Të shpjegosh në vend që të supozosh. Të marrësh frymë thellë në vend që të reagosh menjëherë. Këto veprime mund të duken të vogla, por kanë rëndësi. Ato i mbrojnë të gjithë të përfshirët dhe ndihmojnë në



parandalimin e përshkallëzimit të situatave. Parandalimi shpesh varet nga këto vendime të thjeshta të përditshme. Sjellja e qetë nuk është vetëm një ide. Ajo është diçka që njerëzit e mësojnë përmes përvojave të përditshme. “Kam mësuar se të qëndrosh i qetë më ndihmon të mendoj më qartë. Kur emocionet janë përtej kontrollit tim, atëherë problemet vetëm rriten. Fjalët e qeta krijojnë hapësirë për zgjidhje,” thotë Lis B., katërmëdhjetë vjeç, nga Prishtina. Ndërsa Nevena M. nga Graçanica përqendrohet te sa shpejt mund të ndryshojnë situatat dhe sa shumë ndikim mund të kenë fjalët e qeta dhe sjellja me respekt. “Sjellja me respekt ndryshon gjithçka. Kur njerëzit ndihen se dikush po i dëgjon, atëherë edhe situatat e vështira mund të përfundojnë paqësisht. Paqja fillon vërtet me zgjedhjet tona.” Këta zëra pasqyrojnë një të vërtetë të thjeshtë. Sjellja e qetë nuk është dobësi. Është forcë.



*Një përgjegjësi e përbashkët
Sjellja e qetë nuk është shenjë
dobësie. Është forcë. Trajtimi i
njerëzve në mënyrë të barabartë
nuk është vetëm një rregull,
por një mënyrë për të mbajtur
situatat nën kontroll. Çdo
bashkëbisedim dërgon një
mesazh. Kur ai mesazh është i
qetë dhe me respekt, mjediset
tona të përditshme bëhen vende
më të sigurta për të jetuar dhe
për t'u rritur. Veprimet e vogla
kanë rëndësi. Parandalimi
gjithmonë fillon para se
problemet të rriten. Në fund,
paqja fillon me zgjedhjet tona.*

Na vizitoni në:
Visit us at:



CALM CHOICES, SAFER LIVES

Every day, we interact with each other in our daily lives. We talk to friends, classmates, neighbors, and strangers. We stand in lines, ask questions, share spaces, and solve small problems together. Most of these interactions are simple and end without any issues. But the way we act in these moments matters. Calm or aggressive reactions can shape how situations develop, how safe people feel, and whether small tensions stay small or grow into something harder to control. Sometimes, our daily interactions also include contact with people who represent different services or authorities. In most cases, these moments pass quickly and calmly, but not always. However, every time they escalate, it is clear things could have ended differently if everyone involved had just managed to stay calm.

Why does this matter for your generation?

Young people observe how adults and authority figures behave. They notice how problems are handled in public spaces and online. These experiences shape how trust is built or lost over time. When interactions are calm and respectful, people feel safer. They are more willing to cooperate and help each other. Disagreements do not disappear, but they are handled without fear or violence. This does not mean that every situation is easy or perfect. It means that fairness, respect, and self-control help prevent problems before they grow.

Everyday interactions matter

Small misunderstandings are a normal part of life. Stress, fear, tiredness, or unclear communication can change how a situation feels. When emotions rise, even a simple interaction can suddenly feel uncomfortable or unfair. Most serious problems do not start suddenly. They often grow from small misunderstandings, stress, or fear. A raised voice, a rushed reaction, unclear words, or the feeling of being treated unfairly can increase emotions on all sides. When people feel tense, communication becomes harder. Listening becomes difficult. Assumptions replace understanding. That is how small moments can slowly turn into bigger problems. Calm conduct helps slow things down. It gives people time to understand what is happening and respond clearly. This can prevent a simple situation from turning into conflict.

How does behavior influence outcomes?

The way we speak, listen, and react has real impact. Tone matters. Words matter. Body language matters. These small details can either reduce tension or increase it. Calm behavior does not mean agreeing with everything or giving up your position. It means staying respectful and focused, even when a situation is uncomfortable. It means choosing words carefully and giving others space

to explain. When behavior stays calm and consistent, people feel safer. They are more likely to listen, cooperate, and find solutions. When behavior becomes aggressive or dismissive, emotions rise and trust disappears. Many conflicts could be avoided if people paused for a moment before reacting.

Small actions make a big difference

Violence does not usually begin with big actions. It often starts with small choices. Speaking calmly instead of shouting. Listening instead of interrupting. Explaining instead of assuming. Taking a breath instead of reacting immediately. These actions may seem small, but they matter. They protect everyone involved and help prevent situations from escalating. Prevention often depends on these simple, everyday decisions. Calm conduct is not just an idea. It is something people learn through everyday experiences. “I have learned that staying calm helps me think more clearly. When emotions take over, problems only grow. Calm words give space for solutions,” says fourteen-year-old Lis B. from Pristina. While Nevena M. from Graçanica focuses on how quickly situations can change, and how much difference calm words and respectful behavior can make. “Respectful behavior changes everything. When people feel heard, even difficult situations can end peacefully. Peace really begins with our choices.” These voices reflect a simple truth. Calm conduct is not a weakness. It is strength.

A shared responsibility

Calm conduct is not a sign of weakness. It is strength. Treating people equally is not just a rule, it is a way to keep situations under control. Every interaction sends a message. When that message is calm and respectful, our living environments become safer places to live and grow. Small actions matter. Prevention always starts before problems grow. In the end, peace begins with our choices.

Mendimi juaj për aplikacionet që i përdorni më së shpeshti?



OMER SHALA



Cilin aplikacion e hapni të parin kur e merrni telefonin dhe pse?

E hap Snapchat-in së pari sepse më ndihmon të komunikoj me shokët dhe të shoh çfarë po bëjnë. Është mënyra më e shpejtë për të qëndruar në kontakt dhe për të ndarë momente gjatë ditës.

Cili aplikacion ju ndihmon më shumë në jetën e përditshme, jo vetëm për argëtim?

Snapchat, sepse e përdor për të folur me shokët e klasës për shkollën dhe planet e përditshme, jo vetëm për qejf.

Nëse do të duhej të hiqnit një aplikacion për një javë, cilit do t'ia ndienit më shumë mungesën dhe pse?

TikTok, sepse më pëlqen ta shikoj dhe të relaksohem pas shkollës. Më ndihmon të kaloj kohën kur mërzitem.

Which application do you open first when you take your phone and why?

I open Snapchat first because it helps me communicate with friends and see what they are doing. It is the fastest way to stay in contact and share moments during the day.

Which application helps you more in everyday life, not only for entertainment?

Snapchat, because I use it to talk with classmates about school and daily plans, not only for fun.

If you had to remove one app for a week, which one would you miss the most and why?

TikTok, because I enjoy watching it and relaxing after school. It helps me pass time when I am bored.



LEANDRA REXHEPI



Cilin aplikacion e hapni të parin kur e merrni telefonin dhe pse?

E hap YouTube-in të parin sepse më pëlqen të shikoj video në anglisht dhe të mësoj fjalë të reja. Është interesant dhe më ndihmon të përmirësoj kuptimin tim.

Cili aplikacion ju ndihmon më shumë në jetën e përditshme, jo vetëm për argëtim?

Google, sepse më ndihmon me detyrat e shtëpisë, pyetjet e shkollës dhe gjetjen e informacionit shpejt kur më duhet.

Nëse do të duhej të hiqnit një aplikacion për një javë, cilit do t'ia ndienit më shumë mungesën dhe pse?

Snapchat, sepse komunikoj çdo ditë me shoqet dhe shokët aty dhe do të ndihej e shkëputur pa të.

Which application do you open first when you take your phone and why?

I open YouTube first because I like watching English videos and learning new words. It is also interesting and helps me improve my understanding.

Which application helps you more in everyday life, not only for entertainment?

Google, because it helps me with homework, school questions, and finding information quickly when I need it.

If you had to remove one app for a week, which one would you miss the most and why?

Snapchat, because I communicate with my friends there every day and I would feel disconnected without it.



ESMA SHALA

Cilin aplikacion e hapni të parin kur e merrni telefonin dhe pse?

YouTube, sepse më pëlqen

të shikoj video në gjermanisht dhe të mësoj ndërsa i shikoj. Është edhe argëtues edhe i dobishëm për mua.

Cili aplikacion ju ndihmon më shumë në jetën e përditshme, jo vetëm për argëtim?

Google, sepse kërkoj informacione dhe shpjegime kur nuk kuptoj diçka në shkollë.

Nëse do të duhej të hiqnit një aplikacion për një javë,

cilit do t'ia ndienit më shumë mungesën dhe pse?

Google, sepse nuk do të mund të kërkoja përgjigje dhe detyrat e shkollës do të bëheshin më të vështira.

Which application do you open first when you take your phone and why?

YouTube, because I like watching videos in German and learning while I watch. It is both fun and useful for me.

Which application helps you more in everyday life, not only for entertainment?

Google, because I search for information and explanations when I do not understand something at school.

If you had to remove one app for a week, which one would you miss the most and why?

Google, because I would not be able to search for answers and it would make schoolwork harder.

Your opinion on your most used apps?



LORENA SHALA



Cilin aplikacion e hapni të parin kur e merrni telefonin dhe pse?

Snapchat, sepse i pyes shokët për gjëra të ndryshme dhe qëndroj e informuar gjatë ditës.

Cili aplikacion ju ndihmon më shumë në jetën e përditshme, jo vetëm për argëtim?

ChatGPT, sepse më ndihmon të kuptoj mësimet dhe më jep shpjegime kur kam nevojë për ndihmë.

Nëse do të duhej të hiqnit një aplikacion për një javë, cilit do t'i ndienit më shumë mungesën dhe pse?

Galeria, sepse i ruan kujtimet e mia me familjen dhe shoqërinë dhe më pëlqen të shikoj fotografi të vjetra.

Which application do you open first when you take your phone and why?

Snapchat, because I ask my friends about different things and stay updated with them during the day.

Which application helps you more in everyday life, not only for entertainment?

ChatGPT, because it helps me understand lessons and gives explanations when I need help.

If you had to remove one app for a week, which one would you miss the most and why?

Gallery, because it keeps my memories with family and friends and I like looking at old photos.



ENES SHALA



Cilin aplikacion e hapni të parin kur e merrni telefonin dhe pse?

Snapchat, sepse aty janë shokët e klasës dhe miqtë e mi dhe flasim për shkollën dhe planet për ditën tjetër. Më ndihmon të jem i organizuar.

Cili aplikacion ju ndihmon më shumë në jetën e përditshme, jo vetëm për argëtim?

TikTok, sepse shikoj video që më mësojnë gjëra të reja dhe ndonjëherë më ndihmojnë të kuptoj më mirë temat nëse përdoret si duhet.

Nëse do të duhej të hiqnit një aplikacion për një javë, cilit do t'i ndienit më shumë mungesën dhe pse?

Snapchat, sepse komunikoj me shumë njerëz aty dhe është pjesë e rutinës sime të përditshme.

Which application do you open first when you take your phone and why?

Snapchat, because my classmates and friends are there and we talk about school and plans for the next day. It helps me stay organized.

Which application helps you more in everyday life, not only for entertainment?

TikTok, because I watch videos that teach new things and sometimes help me understand topics better if used correctly.

If you had to remove one app for a week, which one would you miss the most and why?

Snapchat, because I communicate with many people there and it is part of my daily routine.



Please send us your thoughts on your most used apps on this email: magazineforyou2003@gmail.com

MIQ APO RIVALË?

SI NDIKON XHELOZIA NË SHOQËRI?

Miqësia duhet të jetë një vend i sigurt, hapësirë ku qeshim, ndajmë sekrete dhe ndihemi të pranuar. Janë personat të cilëve iu shkruajmë të parëve kur na ndodh diçka e bukur, por edhe i thërrasim kur jemi në vështirësi. Megjithatë, edhe në miqësitë më të mira nganjëherë shfaqet një ndjenjë që i ndërlikon gjërat, xhelozia. Ajo nuk vjen gjithmonë me zë të lartë dhe hapur. Më shpesh përvidhet ngadalë, përmes mesazheve më të ftohta, komenteve të çuditshme ose shakave që “nuk janë asgjë,” por megjithatë të lëndojnë.



Xhelozia mes miqve është më e shpeshtë sesa mendojmë, sidomos gjatë viteve të adoleshencës, kur të gjithë jemi ende duke e kërkuar veten, duke u krahasuar dhe duke e ndër-tuar imazhin tonë.

Pse bëhemi xhelozë ndaj atyre që i duam?

Shumë njerëz besojnë se xhelozia është shenjë e karakterit të keq, por e vërteta është ndryshe. Ajo zakonisht

vjen nga pasiguria dhe frika se nuk jemi mjaftueshëm të mirë. Kur një mik ka nota më të mira, më shumë vetëbesim, më shumë pëlqime, është më i popullarizuar në shoqëri ose e ka një simpati që na pëlqen edhe neve, fillojmë të krahasohemi dhe të pyesim: “Pse jo unë?” Rrjetet sociale e forcojnë edhe më shumë këtë ndjenjë. Në Instagram dhe TikTok të gjithë duken të lumtur, të suksesshëm dhe pa probleme. Kur shohim që miku

ynë merr vëmendje dhe lavdata që ne nuk i kemi, mund të lindë ndjenja se po qëndrojmë në hijen e tij. Në ato momente, xhelozia nuk do të thotë se nuk e duam mikun, por se po luftojmë me pasiguritë tona.

Si shfaqet xhelozia në miqësi?

Xhelozia rrallëherë pranohet drejt-përdrejt. Më shpesh shfaqet përmes sjelljes. Miku mund të bëhet më i largët pa ndonjë arsye të qartë, të përbuzë arritjet e tjetrit me fjali si: “Ah, s’është ndonjë gjë e madhe”, ose shfaqë rivalitet të vazhdueshëm, edhe kur nuk ka nevojë. Ndonjëherë xhelozia shndërrohet në agresivitet pasiv, injorim të mesazheve, komente sarkastike ose thashetheme. Më e keqja është se atëherë miqësia fillon të dëmtohet ngadalë, ndërsa të dyja palët shpesh nuk e kuptojnë shkakun e vërtetë të problemit.

Xhelozia mes miqve është reale dhe njerëzore, sidomos në periudhën e adoleshencës kur të gjithë po ndryshojnë dhe po e kërkojnë vendin e vet. Ajo nuk ka pse ta shkatërrojë miqësinë, por mund ta shkatërrojë nëse shpërfilllet ose shndërrohet në zili.

Miqësia e vërtetë nuk matet me nota, pëlqime apo popullaritet. Ajo do të thotë të gëzoheni për njëri-tjetrin,





edhe kur nuk jeni njësoj. Miqësia nuk është garë ku dikush duhet të fitojë, por një rrugëtim ku më e rëndësishmja është të mos bëheni kundërshtarë, por aleatë.

SI TA TEJKALOSH XHELOZINË

Nëse e vëren xhelozinë te vetja, është e rëndësishme ta dish se kjo nuk të bën person të keq. E rëndësishme është ajo se çka bën me atë ndjenjë.

Së pari - pranoja vetes atë se çka ndjen. T'i thuash vetes se je xheloz apo xheloze nuk është dobësi, por guxim.

Së dyti - ndali krahasimet. Njerëzit nuk e kanë rrugën e njëjtë, nuk i kanë të njëjtat mundësi apo të njëjtat talente. Suksesi i tjetrit nuk do të thotë dështimi yt.

Së treti - mos beso gjithçka që sheh në rrjete. Rrjetet sociale nuk janë jeta reale, por momente të zgjedhura me kujdes.

Së katërti - bisedo me dikë. Nëse mundesh, fol me mi-kun pa akuza, ose besoji dikujt që i zë besë.

Së pesti - ktheje xhelozinë në motivim. Në vend që të të frenojë, le të të shtyjë të punosh me veten.

Më e rëndësishmja - kush-toji kujdes se si ndihesh në atë miqësi. Nëse të dhemb vazhdimisht, ndoshta problemi nuk është vetëm te ti.

FRIENDS OR RIVALS?

HOW DOES JEALOUSY AFFECT FRIENDSHIP?

Friendship should be a safe space, a place where we laugh, share secrets, and feel accepted. These are the people we contact first when something good happens to us, but also the ones we call when we are having a hard time. However, even in the best friendships, a feeling sometimes arises that complicates everything – jealousy. It does not always appear openly. More often, it creeps in quietly, through colder messages, unusual comments, or jokes that “mean nothing” but still hurt.

Jealousy between friends is more common than we think, especially during the teenage years, when we are all still searching for ourselves, comparing, and building our self- image.

Why are we jealous of those we love?

Many people believe that jealousy is a sign of bad character, but the truth is different. It most often arises from insecurity and fear that we are not good enough. When a friend has better grades, more confidence, more likes, is more popular, or has a crush on someone we like, it is easy to start comparing ourselves and ask: “Why not me?” Social networks further reinforce this feeling. On Instagram and TikTok, everyone seems happy, successful, and free of problems. When we see a friend receiving attention and praise that we do not, it can feel as if we are standing in their shadow. In those moments, jealousy does not mean that we do not love our friend, but that we are struggling with our own insecurities.

How is jealousy recognised in friendship?

Jealousy is rarely acknowledged directly. It is more often expressed through behaviour. A friend may become distant for no apparent reason, belittle others' successes with remarks such as, “It is nothing special,” or compete constantly, even when there is no need. Sometimes jealousy turns into passive aggression, such as ignoring messages, making sarcastic comments, or gossiping. The worst aspect is that the friendship then slowly deteriorates, and both parties often do not know the real cause of the problem.

Jealousy between friends is real and human, especially during the teenage years when we are all changing and searching for our place. It does

not have to destroy a friendship, but it can, if ignored or allowed, to turn into envy.

True friendship is not measured by ratings, likes, or popularity. It means that you are happy for each other, even when you are not the same. Friendship is not a race in which someone has to win, but a journey where the most important thing is not to remain opponents, but to become allies.

HOW TO OVERCOME JEALOUSY

If you recognise jealousy in yourself, it is important to understand that you are not a bad person. What matters is how you respond to that feeling.

First, - admit to yourself what you feel. Telling yourself that you are jealous is not weakness, but courage.

Second - stop comparing. No one has the same path, opportunities, or talents. Someone else's success does not mean your failure.

Third - do not believe everything you see on the internet. Social networks are not real life, but carefully selected moments.

Fourth - talk to someone. If you can, speak to a friend without making accusations, or confide in someone you trust.

Fifth - turn jealousy into motivation. Instead of letting it hold you back, let it encourage you to work on yourself.

Most importantly - pay attention to how you feel in that friendship. If you are constantly in pain, perhaps the problem is not just you.

SI T'I KAPËSH SHPEJT GABIMET E IA-SË?

IA mund të përgjigjet shumë shpejt, por shpejtësia nuk do të thotë gjithmonë saktësi. Të mësosh si t'i dallosh gabimet e IA-së herët të ndihmon të kursesh kohë, të shmangësh konfuzionin dhe të mësosh më mirë. Ja disa mënyra të thjeshta për t'i kapur gabimet para se ato të të kapin ty.

⚠️ **Kujdes nga përgjigjet që duken tepër perfekte**

Nëse një përgjigje tingëllon shumë e sigurt, por nuk jep shpjegim, kujdes. Gabimet e IA-së shpesh fshihen pas gjuhës së lëmuar. Kuptimi i vërtetë zakonisht vjen me arsye, jo vetëm me përfundime.

🔍 **Kontrollo emrat, datat dhe numrat**

IA mund t'i ngatërrojë faktet, sidomos emrat, afatet kohore dhe statistikat. Nëse sheh data, vende apo numra konkretë, ndalu pak dhe verifikojini në një burim tjetër.

❓ **Bëje të njëjtën pyetje në një mënyrë tjetër**

Prova ta riformulosh pyetjen. Nëse përgjigjja ndryshon shumë, kjo është shenjë se diçka mund të mos jetë në rregull. Përgjigjet e qëndrueshme zakonisht tregojnë saktësi më të madhe.

🔍 **Kërko detaje që mungojnë**

Ndonjëherë IA jep një përgjigje që është pjesërisht e saktë, por jo e plotë. Nëse ndjen se diçka është kapërcyer ose është shpjeguar me nxitim, kërko më shumë hapa ose shembuj.

🧠 **Besoi konfuzionit tënd**

Nëse një përgjigje nuk ka kuptim, kjo ka rëndësi. Mos e injoro atë ndjenjë. Konfuzioni është shpesh shenja e parë që diçka nuk shkon.

🔄 **Kërko që IA ta kontrollojë veten**

Mund t'i thuash: "Rishiko përgjigjen tënde dhe më thuaj nëse diçka mund të jetë gabim." Kjo shpesh ndihmon të zbulohen gabime të vogla ose pjesë të paqarta.



💡 **MBAJE MEND:**

IA është e shpejtë, por ti je më i zgjuar kur ngadalëson dhe mendon. Kapja e gabimeve nuk ka të bëjë me dyshimin ndaj gjithçkaje, por me të mësuarit se si të pyesësh me mençuri.

HOW TO CATCH AI MISTAKES FAST?

AI can answer quickly, but speed does not always mean accuracy. Learning how to spot AI mistakes early helps you save time, avoid confusion, and learn better. Here are simple ways to catch errors before they catch you.

⚠️ **Watch for answers that sound too perfect**

If an answer sounds very confident but gives no explanation, be careful. AI mistakes often hide behind smooth language. Real understanding usually comes with reasons, not just conclusions.

🔍 **Check names, dates, and numbers**

AI can mix up facts, especially names, timelines, and statistics. If you see specific dates, places, or numbers, take a moment to verify them using another source.

❓ **Ask the same question in a different way**

Try rephrasing your question. If the answer changes a lot, that is a sign something might be wrong. Consistent answers usually mean better accuracy.

🔍 **Look for missing details**


Sometimes AI gives an answer that is partly correct but incomplete. If something feels skipped or rushed, ask for more steps or examples.

🧠 **Trust your confusion**

If an answer does not make sense to you, that is important. Do not ignore that feeling. Confusion is often the first sign that something is off.

🔄 **Ask AI to check itself**

You can say: "Review your answer and tell me if something might be wrong." This often helps catch small mistakes or unclear parts.



💡 **REMEMBER:**

AI is fast, but you are smarter when you slow down and think. Catching mistakes is not about doubting everything, it is about learning how to question wisely.

FJALËKRYQ SKANDINAV

	MENAXHE- RI I NJOH- UR I FUT- BOLLIT NGA FOTO	R. N.	AKTORE AMERIKA- NE, LON- GORIA	POSE- DOJME	ERA E KEND- SHME	QË KA ZILI (SHQ.)							
FSHAT NË KOMUNËN E SKEN- DERAJT													
ISH KAM- PIONI BO- TEROR NË KARATE ID- RIZI (SHQ.)													
FOSFOR		TERM NË MUZIKË											
		MJET LUFTE											
GALIUM			PËREMËR PRONOR COHË E IMET LËKU- RE (SHQ.)										
GODINA MBI LUMË				KAQ (NDAJF.)									
				OPERË E VERDIT									
EMËR FEMRE MUSLI- MANE					ZANORJA E PARË								
					AKTORI BANA								
QYTET NË MINNESO- TA (SHBA)													
500 (ROMAK)		LOJTAR GOLFI, AR- NAUS											
		PRIJËSIT FETARË											
SHKO, LARGOHU			PËREMËR VETOR SHKRIMT. NË EGJIPT. E LASHTË			KAMPION							
PËRSHË- NDETJE SPA- NJOLLE				KALCIUM			AKTORJA MENDES	SOLISTE JONA, FE- VZIE KO- NUSHEVCI	MILAZIM KRASNIQI	MASË THEMELO- RE, BAZË	ENDACAK (PËR PO- PUJT QË ENDEN)	GUXIM- TAR	DY (ROMAK.)
				LUMË NË BRAZIL									
FOTOMO- DELJA KLUM					DREJTËZ GJEOMET- RIKE (SHQ)								
					FUTB. FR- ANCESCO								
LLOJ PA- PAGALLI BISHT, GJATË						EMËR MA- SHKULLI KUZHINA PRANE XHAMISË							
SHKRONJË E PARË E EMRIT APO E MBIE- MRIT TË NJË PERSONI									SHOK, MIK (FR.)				AI QË IKËN, IKANAK
SUNDIMTAR I EGËR									NDENJËSE E ULET (SH. SH.)				
SIMENS		QYTET NË POLONI					SOLIST YNI, BEDRI						
		AKTORJA GARBO					KASTRIOT ISLAMI						
SIMBOLI KIMIK I ARGJE- NDIT			SHTET NË AZI					REGJISOR AMERIKAN, WILLIAMS				KELVIN	
			FUTBOLLI- ST SUEDEZ, ALEXANDER					KATRAN				BËRA NJË LUTJE	
NUMRI QË VIE PAS NUMRIT 2				PIKTORI BRITANIK, RIVIERE							LANTAN		
				METËR, RENIUM							QYTET NË EGJIPT		
EMËR FEMRE							E. L.			FRIKACAK			
							ENERGJI MEKANIKE			"KOKTEJ ENIG- MATIK"			
KRYEQY- TET I PRO- VINCES ADRAR NË MAURITANI					TOKË E KUQE E PJEKUR KOHA								
MBËSHT- JELLJE NË NJË KUTI								VEND I THATË, PA UJË					



"Për çdo minutë zemërim, ti i humb gjashtëdhjetë sekonda lumturi."

Ralph Waldo Emerson